

Vlerësimi i Zhvillimit të Bujqësisë së Qëndrueshme në Kosovë



Tetor 2024

Mohim përgjegjësie:

Ky raport mbështetet nga Projekti për Promovimin e Punësimit në Sektorin Privat (PPSE) dhe është përgatitur nga një ekip studiuesish, Laura Courbois, Arben Mehmeti dhe Egzon Bajrami. Opinionet e shprehura dhe argumentet e paraqitura këtu nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet zyrtare të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Projektit PPSE, Swisscontact-it, apo Institutit Riinvest.

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Hyrje.....	5
2. Objektivat dhe metodologjia e kërkimit.....	5
2.1. Objektivat.....	5
2.2. Metodologjia.....	6
3. Konteksti i zhvillimit të bujqësisë në Kosovë	7
3.1. Rritja ekonomike në Kosovë	7
3.2. Gjendja aktuale: sektori i bujqësisë	8
3.3. Sfidat që prekin në sektorin e bujqësisë në Kosovë	9
3.4. Bujqësia e qëndrueshme në Kosovë	10
3.5. Akterët kryesorë që promovojnë bujqësinë e qëndrueshme	12
4. Kornizat rregullatore dhe politikat	16
4.1. Dokumentet strategjike të Kosovës, kornizat rregullatore dhe politikat relevante për kalimin e sektorit në bujqësi të qëndrueshmëri	16
4.2. Politikat dhe strategjitë e tjera përkatëse.....	21
4.3. Analizë krahasuese e politikave dhe strategjive të Kosovës dhe BE-së.....	26
5. Vlerësimi i gatishmërisë së sektorit të bujqësisë	28
5.1. Praktikrat dhe nismat ekzistuese të qëndrueshmërisë të zbatuara nga NVM-të në sektorin bujqësisë në Kosovë	28
5.2. Sfidat dhe pengesat me të cilat përballen NVM-të bujqësore në Kosovë për përdorimin e praktikave të qëndrueshme.	32
5.3. Mundësitë dhe fushat për intervenim	35
6. Mundësitë e financimit dhe mekanizmat financiarë	40
6.1. Burimet e financimit nga sektori publik	40
6.2. Burimet e financimit nga sektori privat	43
6.3. Burime të tjera të financimit.....	44
6.4. Mundësitë alternative të financimit në kuadër të programit IPARD III.....	46
7. Mundësitë/rekomandimet për të mbështetur tranzicionin e qëndrueshëm dhe të gjelbër .	48
8. Shtojca 1 – Lista e palëve të interesit.....	55
9. Shtojca 2 – Informacion mbi rregulloret	56

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport paraqet një analizë gjithëpërfshirëse të sektorit të bujqësisë së qëndrueshme në Kosovë, i porositur nga projekti – Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (ang. Promoting Private Sector Employment - PPSE). Studimi është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim të Kosovës 2030 dhe Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, veçanërisht zotimet e përfshira në ‘Deklaratën e Sofjes’ për bujqësi të qëndrueshme dhe prodhim të ushqimit. Qëllimi kryesor është të lehtësojë kalimin e Kosovës drejt një ekonomie konkurruese, inovative dhe mjedisore të qëndrueshme, me fokus të veçantë në sektorin e bujqësisë.

Konteksti dhe objektivat

Peizazhi ekonomik i Kosovës karakterizohet nga një strukturë e orientuar drejt shërbimeve, ku bujqësia kontribuon me një pjesë të vogël, por thelbësore, në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), me rreth 7.4%. Pavarësisht rritjes së konsiderueshme të prodhimit bujqësor gjatë dekadës së kaluar, sektori përballlet me sfida që lidhen me fragmentimin e tokës, infrastrukturën e vjetruar, qasjen e kufizuar në financa dhe presionet mjedisore. Projekti PPSE, ka porositur këtë studim për të vlerësuar gatishmërinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në sektorin e bujqësisë në Kosovë për të përqafuar praktikave të qëndrueshmërisë dhe tranzicionit të gjelbër. Objektivat e studimit përfshijnë vlerësimin e praktikave aktuale të qëndrueshmërisë, identifikimin e pengesave, vlerësimin e mekanizmave mbështetës në dispozicion, analizimin e kornizave rregullatore dhe identifikimin e mundësive për intervenim.

Metodologjia

Në studim është përdorur qasje e kombinuar metodologjike, duke ndërthurur kërkimin cilësor dhe atë sasior për të kuptuar më thellë gjendjen e tanishme të bujqësisë së qëndrueshme në Kosovë. Dizajni i këtij raporti kërkimor përfshin rishikimin e literaturës, intervista me informatorë kryesorë (IHK) dhe diskutime në grupe të fokusuara (DGF) me një gamë të larmishme të palëve të interesit, duke përfshirë zyrtarë qeveritarë, NVM, organizatë jo-qeveritare (OJQ) dhe organizata ndërkombëtare. Mostrimi është përqendruar në katër nën-sektorë bujqësorë kryesorë me potencial të lartë për praktika të qëndrueshme: frutat e buta, bimët mjekësore dhe aromatike (BMA), qumështi dhe produktet e tij, dhe perimet.

Gjetjet kryesore

1. **Gjendja aktuale e bujqësisë së qëndrueshme:** Studimi zbuloi se, megjithëse ka një rritje të ndërgjegjësimit dhe zbatimit të praktikave të qëndrueshme në mesin e NVM-ve në sektorin e bujqësisë në Kosovë, sfida të konsiderueshme ende vazhdojnë të ekzistojnë. Praktikave kryesore të adoptuara përfshijnë përdorimin e paneleve diellore, plehrave organike, sistemin e ujitjes pikë-pikë dhe respektimin e standardeve Global GAP dhe certifikimin organik. Megjithatë, këto praktika drejtohen kryesisht nga grante dhe subvencione të jashtme, me nismë të kufizuar nga vetë fermerët.
2. **Pengesat për adoptim:** Pengesat kryesore për adoptimin e praktikave të qëndrueshme përfshijnë shqetësimet për qëndrueshmërinë ekonomike, mungesën e mbështetjes teknike dhe trajnimeve, zbatimin e pamjaftueshëm rregullator dhe mungesën e fermave model. Shumë fermerë i perceptojnë praktikave të qëndrueshme si financiarisht të papërbalueshme, pa përfitime ekonomike të qarta dhe të menjëhershme, duke çuar në rezistencë ndaj ndryshimeve.
3. **Mekanizmat dhe burimet e mbështetjes:** Studimi theksoi rolin e rëndësishëm të mbështetjes qeveritare dhe donatorëve në promovimin e bujqësisë së qëndrueshme. Megjithatë, efikasiteti i këtyre mekanizmave mbështetjes shpesh kufizohet nga

koordinimi i pamjaftueshëm, programet joadekuate të trajnimit dhe mungesa e ndërgjegjësimit në mes fermerëve për burimet në dispozicion. Mekanizmat financiarë, duke përfshirë pagesat direkte dhe grantet, veçse zbatohen por duhet të riorientohen më mirë me objektivat e qëndrueshmërisë.

4. **Kornizat rregullatore dhe politike:** Korniza rregullatore e Kosovës për bujqësinë po përafrohet gradualisht me standardet e BE-së, por mbeten boshllëqe të konsiderueshme, veçanërisht në fushat që lidhen me mbrojtjen mjedisore, menaxhimin e ujit dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës. Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (SBZHR) 2022-2028, përcakton qëllime ambicioze për përputhjen e politikave bujqësore të Kosovës me Politikën e Përbashkëta Bujqësore të BE-së (PPB), por zbatimi ka qenë i ngadalshëm dhe i paqëndrueshëm.
5. **Mundësitë për intervenime:** Raporti identifikon disa fusha kritike për intervenim, duke përfshirë forcimin e trajnimeve teknike dhe shërbimeve këshilluese, përmirësimin e qasjes në treg për produktet e prodhuara në mënyrë të qëndrueshme, ofrimin e stimuljeve ekonomike të përshtatur për praktikën e qëndrueshme, dhe forcimin e lidhjes ndërmjet sektorit privat dhe akademisë. Mundësitë specifike përfshijnë investime në infrastrukturën e menaxhimit të mbeturinave, promovimin e përdorimit të energjisë së rinovueshme, dhe shfrytëzimin e kërkesës në treg për të nxitur qëndrueshmërinë.

Përfundime dhe rekomandime

Si përfundim, megjithëse sektori i bujqësisë në Kosovë është në rrugë drejt qëndrueshmërisë, ka nevojë për përpjekje më të fuqishme dhe të koordinuara për të përballuar sfidat ekzistuese. Rekomandimet përfshijnë:

- **Forcimin e mbështetjes teknike:** Përmirësimi i trajnimeve teknike dhe shërbimeve këshilluese për fermerët është thelbësore për të rritur adoptimin e praktikave të qëndrueshme. Kjo duhet të përfshijë krijimin e zyrave të dedikuara në kuadër të komunave lokale dhe inkurajimin e partneriteteve publike-private.
- **Përshtatjen e stimuljeve financiarë:** Mekanizmat financiarë duhet të përshtaten më mirë me qëllimet e qëndrueshmërisë, duke përfshirë skemat e granteve të përshtatura që inkurajojnë adoptimin e praktikave miqësore me mjedisin. Monitorimi dhe vlerësimet e ndikimit të këtyre investimeve janë thelbësore për të siguruar efikasitetin e tyre.
- **Përmirësimin e qasjes në treg:** Lehtësimi i qasjes në tregjet e brendshme dhe ndërkombëtare për produktet bujqësore të prodhuara në mënyrë të qëndrueshme mund të nxisë kërkesën për praktikën e gjelbra. Sektorët e orientuar drejt eksportit siç është sektori i BMA-së ofron një model se si kërkesat e tregut mund të promovojnë qëndrueshmërinë.
- **Forcimin e kornizave rregullatore:** Ka nevojë për një forcim më të rreptë të rregulloreve ekzistuese dhe zhvillimin e politikave të reja që janë në përputhje me standardet e BE-së, veçanërisht në mbrojtjen mjedisore dhe menaxhimin e burimeve.
- **Rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit:** Rritja e ndërgjegjësimit ndërmjet fermerëve dhe konsumatorëve për përfitimet e bujqësisë së qëndrueshme është thelbësore. Përfshirja e qëndrueshmërisë në kurrikulat shkollore dhe zgjerimi i aktiviteteve kërkimore mbi praktikën e qëndrueshme do të mbështeste zhvillimin afatgjatë të sektorit.

1. Hyrje

Bazuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim të Kosovës 2030¹, **vendi synon të krijojë një mjedis të favorshëm për biznese dhe të kontribuojë aktivisht në zhvillimin e një ekonomie konkurruese të orientuar drejt aktiviteteve produktive dhe shërbimeve me vlerë të shtuar.** Inovacioni, një faktor kyç për konkurrueshmërinë, si dhe ekonomia qarkore, si një model i zhvillimit të qëndrueshëm, do të kenë theks të veçantë në këtë drejtim të ri ekonomik. Sipas strategjisë 2030, transformimi ekonomik i Kosovës do të bazohet në ndërmarrje konkurruese, inovative dhe mjedisore të qëndrueshme, duke lehtësuar kushte të favorshme për rritjen e pjesëmarrjes së ndërmarrjeve kosovare në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës.

Në përputhje me qëllimet kryesore të përfshira në Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, ‘Deklarata e Sofjes’ përfshin një kaptinë të veçantë që adreson bujqësinë e qëndrueshme dhe prodhimin e ushqimit. Në këtë kuadër, **Kosova ka konfirmuar zyrtarisht zotimet për të avancuar qëndrueshmërinë në fushat e bujqësisë dhe prodhimit të ushqimit** duke e miratuar këtë marrëveshje të rëndësishme. Ky zotim përfshin sigurimin që sektorë të ndryshëm të industrisë ushqimore—duke përfshirë bujqësinë, përpunimin, shpërndarjen, konsumimin e ndërgjegjshëm dhe menaxhimin efikas të mbeturinave ushqimore—të përputhen me standardet dhe praktikën e vendosura nga Bashkimi Evropian (BE).

Në përputhje me drejtimin strategjik të Qeverisë së Kosovës, e cila përfshin zotime për të promovuar tranzicionin e gjelbër në politikat kombëtare, dhe në koordinim me përpjekjet e komunitetit të donatorëve dhe agjencive të zhvillimit, projekti PPSE, synon të shfrytëzojë ekspertizën e gjerë për të avancuar këtë qëllim të përbashkët. Qëllimi i projektit PPSE është të përmirësojë konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve të Kosovës duke promovuar praktika të qëndrueshme, duke krijuar vende pune të gjelbra dhe duke nxitur mirëqenien ekonomike brenda një mjedisi të pastër.

Raporti fillimisht shqyrton kornizat rregullatore dhe politike të Kosovës, duke theksuar boshllëqet dhe fushat për përmirësim, veçanërisht në përputhje me standardet e BE-së. Pastaj, përfshin një analizë të gjendjes aktuale të bujqësisë së qëndrueshme në Kosovë, duke identifikuar praktikën kryesore, pengesat për adoptim dhe mekanizmat mbështetës. Kapitulli i ardhshëm paraqet mekanizmat e ndryshëm të financimit që janë në dispozicion për të mbështetur kalimin në bujqësi të gjelbër, dhe në fund, raporti përfundon me rekomandime për forcimin e trajnimeve teknike, përmirësimin e qasjes në treg për produktet e prodhuara në mënyrë të qëndrueshme, dhe përforcimin e zbatimit rregullator për të nxitur adoptimin e praktikave të qëndrueshme.

2. Objektivat dhe metodologjia e kërkimit

2.1. Objektivat

Për të kontribuar më tej në avancimin e nismave të gjelbra dhe të qëndrueshme në sektorin e bujqësisë, **PPSE ka porositur një studim me qëllim të vlerësimit të gatishmërisë dhe përgatitjes së NVM-ve të Kosovës në sektorin e bujqësisë lidhur me kalimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe aplikimit të praktikave të tranzicionit të gjelbër.**

¹ <https://kryeministri.rks-gov.net/en/national-development-strategy-2030/>

Objektivat specifikë të këtij studimi përfshijnë:

Vlerësimin e praktikave të tanishme të qëndrueshmërisë:

- Vlerësimin e praktikave dhe nismave ekzistuese të qëndrueshmërisë të zbatuara nga NVM-të në sektorin e bujqësisë në Kosovë.
- Përcaktimin e nivelit të ndërgjegjësimit dhe njohurive të NVM-ve bujqësore për përfitimet e tranzicionit të gjelbër dhe qëndrueshmërisë.

Identifikimi i pengesave dhe sfidave:

- Hulumtimin e sfidave dhe pengesave kryesore me të cilat ballafaqohen NVM-të bujqësore në Kosovë për adoptimin e praktikave të qëndrueshme.
- Analizimin e kufizimeve financiare, rregullatore dhe teknike që pengojnë tranzicionin e gjelbër.

Vlerësimin e mekanizmave dhe burimeve mbështetëse:

- Hulumtimin e burimeve dhe mundësive të financimit që janë në dispozicion, duke përfshirë IPARD III, për të mbështetur nismat e qëndrueshmërisë së NVM-ve bujqësore.
- Vlerësimin e efikasitetit të mbështetjes aktuale qeveritare dhe institucionale në lehtësimin e tranzicionit të gjelbër.

Analizimin e kornizave rregullatore dhe politikave:

- Rishikimin e dokumenteve strategjike të Kosovës, kornizat rregullatore dhe politikave të duhura që lidhen me kalimin e sektorit në bujqësi të qëndrueshme.
- Identifikimin e boshllëqeve dhe mospërputhjeve në politikave që mund të pengojnë tranzicionin e gjelbër të NVM-ve.
- Krahasimin dhe referimin e politikave ose strategjive përkatëse të BE-së dhe atyre ndërkombëtare që lidhen me tranzicionin e gjelbër në sektorin e bujqësisë.

Identifikimin e mundësive dhe fushave për intervenim:

- Identifikimin e mundësive kritike brenda sektorit të bujqësisë për NVM-të që mund t'i shfrytëzojnë përgjatë tranzicionit drejt qëndrueshmërisë.
- Përcaktimin e fushave specifike për intervenim që do t'i ndihmonte NVM-të në aplikimin e praktikave të biznesit të qëndrueshëm dhe miqësor me mjedisin.

2.2. Metodologjia

Ky studim ka përdorur një qasje të kombinuar metodologjike, duke bashkuar teknikat kërkimore cilësore dhe sasore për të vlerësuar gatishmërinë dhe përgatitjen e NVM-ve të Kosovës në sektorin e bujqësisë për tranzicionin e gjelbër. Metodologjia është dizajnuar për të mbledhur njohuri të thelluara dhe të dhëna të qëndrueshme mbi praktikave aktuale të qëndrueshmërisë, sfidat dhe mundësitë, si dhe efikasitetin e mekanizmave mbështetës dhe kornizat rregullatore.

Dizajni i kërkimit

Dizajni i këtij kërkimi përfshin komponentët kryesorë të mëposhtëm:

Rishikimin e literaturës: Është bërë një rishikim i plotë i dokumenteve të rëndësishme, duke përfshirë dokumentet kryesore të politikave, kornizat ligjore dhe planet strategjike. Ky rishikim

ofron kuptim themelor të politikave dhe strategjive ekzistuese që promovojnë bujqësinë e qëndrueshme në Kosovë.

Mbledhja e të dhënave primare:

Intervistat me informatorë kryesorë (IIK): Janë realizuar intervista të thelluara me një gamë të larmishme të palëve të interesit, duke përfshirë zyrtarë qeveritarë, përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare, OJQ-të, dhe akterë të tjerë të rëndësishëm të tregut, përfshirë ofruesit e shërbimeve financiare dhe furnizuesit e inputeve bujqësore. Këto intervista kishin për qëllim të mbledhin informacione të detajuara mbi praktikat aktuale, ndërgjegjësimin, sfidat dhe mekanizmat mbështetës.

Diskutimet në grupe të fokusuar (DGF): DGF-të janë organizuar me grupe të ndryshme si NVM-të, fermerët dhe përfaqësuesit e OJQ-ve. Këto diskutime kanë lehtësuar eksplorimin e përvojave të përbashkëta, perceptimeve dhe njohurive të përbashkëta mbi praktikat e qëndrueshme dhe tranzicionin e gjelbër.

Mostrimi

Duke marrë parasysh fushën e studimit, është përdorur një qasje e qëllimshme për marrje të mostrave. Studimi fokusohet në katër nën-sektorë kryesorë bujqësorë me potencial të lartë për t'u përfshirë në tranzicionin e gjelbër: frutat e buta, BMA-të, qumështi dhe produktet e tij, dhe perimet. Këta nën-sektorë janë zgjedhur mbi bazën e rëndësisë së tyre ekonomike, pranisë në treg, pozitës konkurruese dhe numrit të konsiderueshëm të fermerëve të angazhuar në këta sektorë.

Lista e plotë e palëve të interesit që janë konsultuar për këtë raport kërkimor është i përfshirë në shtojcën 1.

Analiza e të dhënave

Të dhënat e mbledhura dhe të shqyrtuara janë analizuar kryesisht duke përdorur metoda cilësore. Më konkretisht, është kryer një analizë tematike mbi transkriptet e intervistave dhe DGF-ve për të identifikuar temat kryesore, modelet dhe njohuritë. Kjo përfshin kodimin e të dhënave dhe kategorizimin e tyre në tema domethënëse që lidhen me praktikat e qëndrueshmërisë, sfidat dhe mekanizmat mbështetës.


3. Konteksti i zhvillimit të bujqësisë në Kosovë

3.1. Rritja ekonomike në Kosovë

Kosova, ka një ekonomi me të ardhura të mesme të larta dhe është kryesisht e orientuar drejt shërbimeve, me shumicën e fuqisë punëtore të punësuar në sektorin e shërbimeve. Pas një rënieje të shkaktuar nga pandemia COVID-19, ekonomia u rimëkëmb dhe vazhdoi të rritet, ndërsa inflacioni, i cili u rrit ndjeshëm në vitin 2022 për shkak të faktorëve globalë, filloi të ulet në vitin 2023.

Ekonomia e Kosovës klasifikohet si ekonomi e vogël me të ardhura të mesme të larta, me PBB prej 9.68 miliard euro në vitin 2023². Ekonomia e vendit është kryesisht e orientuar

² <https://www.imf.org/external/datamapper/profile/UVK>



drejt shërbimeve, me sektorin e shërbimeve që përbën 45.5% të PBB-së. Sektorët e industrisë dhe bujqësisë kontribuojnë me 27.6% përkatësisht 7.4%³. Punësimi është kryesisht në sektorin e shërbimeve, i cili përbën 72% të vendeve të punës, ndërsa sektori i industrisë dhe bujqësisë punësojnë 23.9% dhe 4% të fuqisë punëtore⁴. Sektori informal besohet se përfaqëson 35% të punësimit që nga viti 2017⁵.

Ekonomia e Kosovës, e cila tregoi zhdërvjelltësi të konsiderueshme pas pandemisë COVID-19, tani po përjeton rritje më të moderuar, por pritet të vazhdojë të zgjerohet. Pas një tkurrjeje prej 5.3% të PBB-së në vitin 2020, ekonomia u rikthye me 10.7% në vitin 2021 dhe u rrit me 3.5% në vitin 2022⁶. Rimëkëmbja e vitit 2022, u nxit nga eksportet më të mëdha, rritja e konsumit privat, remitancat më të larta dhe kredi më të mëdha nga bankat. Rritja ekonomike u nxit kryesisht nga sektorët e tregtisë dhe shërbimeve. Deri në tremujorin e tretë të vitit 2023, PBB-ja ka shënuar rritje prej 6.6% në krahasim me vitin e kaluar.

Inflacioni, i cili u rrit ndjeshëm në vitin 2022, për shkak të rritjes së çmimeve globale të ushqimeve dhe energjisë, të shkaktuara nga lufta e Rusisë në Ukrainë, filloi të zbutet në vitin 2023, pasi rritja e çmimeve globale të mallrave u zvogëlua. Pritet që deri në vitin 2025⁷ të vazhdojë të ketë rënie. Inflacioni ka rënë nga 11.6% në vitin 2022 në 4.9% në vitin 2023, si rezultat i çmimeve më të ulëta të mallrave.

3.2. Gjendja aktuale: sektori i bujqësisë

Gjatë dekadës së fundit, industria e bujqësisë në Kosovë ka pasuar rritje prej 54%, si rezultat i rritjes së investimeve dhe mbështetjes nga qeveria, duke diversifikuar prodhimin e saj dhe duke u përballur me sfida në punësim dhe qasje në treg, me pjesëmarrjen e sektorit në PBB në rënie të lehtë dhe deficitet tregtare që vazhdojnë, pavarësisht përmirësimit të produktivitetit.

Përgjatë dhjetë viteve të fundit, industria e bujqësisë në Kosovë ka rritur prodhimin e saj nga 428 milion euro në vitin 2013 në 658 milion euro në vitin 2022⁸. Kjo rritje prej 54% është kryesisht si rezultat i investimeve më të mëdha dhe mbështetjes nga qeveria. Pavarësisht kësaj rritjeje në vlerë, pjesëmarrjen e sektorit në PBB ka rënë paksa nga 8.4% në 7.8% në vitin 2023. Për më tepër, norma vjetore e rritjes së sektorit ka qenë mjaft e ndryshueshme, me rritje që ka ndodhur vetëm në dy nga gjashtë vitet nga viti 2017 deri në vitin 2022, dhe ky i fundit ka treguar një rritje modeste prej vetëm 4.5%.

Sa i përket prodhimit bujqësor, sektori i bujqësisë në Kosovë ka diversifikuar prodhimin përgjatë dy dekadave të fundit, me rritje të rëndësishme në prodhimin e frutave dhe perimeve, bagëtime dhe bylmetit, si dhe të kulturave speciale. Më konkretisht, sektori i bujqësisë në Kosovë ka evoluar ndjeshëm, me produkte thelbësore si gruri dhe misri që prodhojnë vazhdimisht rreth 50,000 deri në 90,000 ton në vit. Patatet dhe një gamë e gjerë e perimeve gjithashtu kontribuojnë ndjeshëm në prodhimin total, me pemët që shtojnë rreth 30,000 ton çdo vit. Sa i përket eksportit, prodhimet e freskëta të pemëve dhe perimeve janë të rëndësishme, sidomos për vendet fqinje dhe BE-në. Tregu i ngushtë për barishte, bimë

³ <https://databank.worldbank.org/source/world-development-indicators>

⁴ https://ilostat.ilo.org/data/countryprofiles/?ref_area=KOS

⁵ <https://documents1.worldbank.org/curated/en/814361497466817941/pdf/Kosovo-Jobs-Diagnostic.pdf>

⁶ https://economyfinance.ec.europa.eu/document/download/00bb7307-1694-4c7e-99de5c3e662b2172_en?filename=tp070_en.pdf

⁷ https://economyfinance.ec.europa.eu/document/download/00bb7307-1694-4c7e-99de5c3e662b2172_en?filename=tp070_en.pdf

⁸ <https://databank.worldbank.org/source/world-development-indicators>

mjekësore dhe produkte organike po rriten, krahas një tregu në zgjerim të eksportit të verërave. Pavarësisht sfidave siç është qasja në treg dhe presionet konkurruese, sektori i bujqësisë në Kosovë po përfiton nga produkte me vlerë të lartë dhe produkte të veçanta, duke përmirësuar praktikën dhe cilësinë e produkteve për të nxitur rritjen si në nivel vendor ashtu edhe atë ndërkombëtar.

Roli i këtij sektori në punësim mbetet minimal, duke shënuar nivelet më të ulëta në Ballkanin Perëndimor (BP). Kjo rënie lidhet me ndryshimet demografike siç janë shkalla e ulët e lindshmërisë dhe migrimi i konsiderueshëm i të rinjve, si dhe modernizimi i sektorit⁹. Për më tepër, punësimi informal është i pranishëm në Kosovë, veçanërisht në sektorin e bujqësisë. Toka bujqësore përbën rreth 38% të sipërfaqes totale të tokës në Kosovë. Njësoj si vendet e tjera të BP-së, sektori karakterizohet nga bujqësia gjysmë mbijetese, në parcela të vogla dhe të fragmentuara. Sipas të dhënave më të fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), madhësia mesatare e një njësie bujqësore është rreth 1.5 hektarë. Kjo është përgjithësisht më e vogël krahasuar me shumë nga vendet fqinje, dhe veçanërisht krahasuar me mesataren e BE-së prej 17.4 hektarë¹⁰.

Sektori i ushqimit dhe pijeve është përballur me deficit tregtar të konsiderueshëm, duke arritur 739 milion euro në vitin 2021. Megjithëse deficitin nominal është rritur, pjesërisht për shkak të rritjes së inflacionit, raporti i eksporteve ndaj importeve është përmirësuar nga 5% në vitin 2010 në mbi 10% në vitin 2021¹¹. Ky ndryshim pozitiv i atribuohet produktivitetit të përmirësuar brenda sektorit të bujqësisë, i nxitur nga infrastruktura e modernizuar dhe rritja e investimeve.

3.3. Sfidat që prekin në sektorin e bujqësisë në Kosovë

Siç u përmend më lart, sektori i bujqësisë në Kosovë përballlet me disa kufizime kyçe që kufizojnë rritjen, produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e tij. Këto kufizime janë të rrënjësura në sfidat ekonomike, strukturore, mjedisore dhe institucionale.

Një përmbledhje e shkurtër është dhënë në tabelën në vijim:

KUFIZIMI	PËRSHKRIMI
Pronësia e tokës e fragmentuar	Toka bujqësore e Kosovës është shumë e fragmentuar, me parcela të vogla dhe të shpërndara që e vështirëson bujqësinë efikase. Shumica e fermave janë në pronësi familjare dhe mesatarisht janë më pak se 2 hektarë, gjë që pengon ekonomizimin e shkallës dhe kufizon investimet në teknika moderne të bujqësisë. Fragmentimi çon në efikasitet të ulët, kosto më të larta të prodhimit dhe vështirësi në mekanizim dhe ujitje.
Infrastruktura dhe teknologjia e vjetëruar	Shumica e infrastrukturës bujqësore në Kosovë është e vjetëruar, duke përfshirë sistemin e ujitjes, objektet e magazinimit dhe lidhjet për transport. Fermerët shpesh varen nga makineri të vjetra dhe nuk kanë qasje në teknologjitë moderne bujqësore.

⁹<https://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=24031&langId=en>.

¹⁰ <https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/SEPDF/cache/73319.pdf>

¹¹<https://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=24031&langId=en>.

<p>Qasje e kufizuar në financa</p>	<p>Fermerët në Kosovë përballen me sfida të konsiderueshme për qasjen në financa. Sektori i bujqësisë perceptohet me rrezik të lartë nga bankat, që çon në disponueshmëri të kufizuar të kredisë dhe norma të larta interesi. Për më tepër, shumë fermerë kanë mungesë të kolateralit të nevojshëm për të siguruar kredi. Kjo kufizon investimet në modernizimin e fermave, zgjerimin dhe përdorimin e teknologjive të reja.</p>
<p>Mungesa e shërbimeve efikase të zgjerimit bujqësor dhe edukimit bujqësor</p>	<p>Shërbimet e zgjerimit bujqësor, të cilat ofrojnë njohuri teknike dhe trajnime për fermerët, janë të pazhvilluara në Kosovë. Mungesa e shërbimeve efikase të zgjerimit bujqësor dhe edukimit bujqësor do të thotë që shumë fermerë nuk janë në dijeni të praktikave moderne dhe të qëndrueshme bujqësore ose nuk dinë si t'i zbatojnë ato. Kjo kufizon produktivitetin, redukton inovacionin dhe pengon adoptimin e praktikave miqësore me mjedisin.</p>
<p>Qasje e dobët në treg dhe zinxhirët e vlerës</p>	<p>Sektori bujqësisë në Kosovë përballlet me qasje të dobët në treg, si në nivel vendor ashtu edhe atë ndërkombëtar. Zinxhirët e vlerës janë të pazhvilluar dhe mundësitë për fermerët që të angazhohen në përpunimin e produkteve me vlerë të shtuar janë të kufizuara.</p>
<p>Sfidat mjedisore dhe ndryshimet klimatike</p>	<p>Sektori i bujqësisë në Kosovë është i ndjeshëm ndaj sfidave mjedisore siç janë degradimi i tokës, mungesa e ujit dhe ndotja. Për më tepër, ndryshimet klimatike po shkaktojnë ngjarje klimatike më të shpeshta dhe më të rënda, duke përfshirë thatësitrat, përmytjet dhe ndryshimet në temperatura.</p>
<p>Mbështetje dhe qeverisje e dobët institucionale</p>	<p>Sektori i bujqësisë në Kosovë vuan nga mbështetja e dobët institucionale, duke përfshirë zbatimin jo konsistent të politikave, koordinimin e kufizuar ndërmjet agjencive qeveritare dhe zbatimin e pamjaftueshëm të rregulloreve. Politikat bujqësore shpesh nuk janë plotësisht të harmonizuara me standardet e BE-së, të cilat Kosova aspirojnë t'i përmbushë.</p>
<p>Mungesa e fuqisë punëtore dhe shpopullimi në zona rurale</p>	<p>Zonat rurale në Kosovë po përjetojnë shpopullim, me shumë të rinj që migrojnë në zonat urbane ose jashtë vendit në kërkim të mundësive më të mira. Kjo ka çuar në mungesë të fuqisë punëtore në bujqësi, ku fuqia punëtore po plaket dhe është gjithnjë e më e pamjaftueshme.</p>
<p>Standarde të pamjaftueshme për sigurinë dhe cilësinë e ushqimit</p>	<p>Kosova përballlet me sfida në zbatimin e standardeve për sigurinë dhe cilësinë e ushqimit, të cilat janë thelbësore për qasje në tregjet ndërkombëtare. Shumë ferma dhe objekte përpunuese nuk plotësojnë standardet e nevojshme, dhe ka mungesë të infrastrukturës për monitorim dhe certifikim. Standardet e pamjaftueshme për sigurinë dhe cilësinë e ushqimit kufizojnë aftësinë e Kosovës për të eksportuar produkte bujqësore, sidomos në BE.</p>

3.4. Bujqësia e qëndrueshme në Kosovë

Kosova ka bërë përparim të konsiderueshëm në bujqësinë e qëndrueshme, megjithatë përpjekjet e saj janë ende në zhvillim dhe po përballlet me disa sfida. Përfshirja e vendit në bujqësinë e qëndrueshme përfshin një kombinim të nismave të politikave, adoptimin e praktikave të qëndrueshme nga fermerët dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Në vijim është një përmbledhje e aspekteve kryesore të angazhimit të Kosovës në bujqësi të qëndrueshme:

Korniza e politikave dhe orientimit strategjik

Qeveria e Kosovës ka zhvilluar strategji që synojnë promovimin e bujqësisë së qëndrueshme. Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (ARDP) 2014-2020, hodhi bazat për përmirësimin e praktikave bujqësore, me qëndrueshmërinë në fokus kryesor. Strategjia e re për vitet 2022-2028, e vazhdon këtë trend duke vënë theksin në mbrojtjen e mjedisit, efikasitetin e burimeve dhe zhvillimin rural. Për më tepër, politikat bujqësore të Kosovës gradualisht po harmonizohen me standardet e BE-së, si pjesë e aspiratave për integrim në BE. Kjo përfshin adoptimin e masave në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, sigurinë ushqimore dhe praktikën e qëndrueshme bujqësore. Kjo trajtohet më në detaje në kaptinën 6, të këtij raporti.

Praktikat e bujqësisë së qëndrueshme

Disa fermerë në Kosovë po zbatojnë praktika agro-ekologjike, siç është rotacioni i kulturave, përdorimi i reduktuar i plehrave kimike dhe praktika të tjera përkatëse të qëndrueshmërisë. Për më tepër, ka një interesim në rritje për bujqësinë organike, megjithëse ajo është ende një pjesë e vogël e prodhimit të përgjithshëm bujqësor. Fermerët po adoptojnë gradualisht praktikën organike, të mbështetura nga subvencione dhe stimuj qeveritarë. Kjo çështje shpjegohet më tej në kaptinën 5 të këtij raporti.

Prodhimi organik

Kosova ka klimë dhe tokë të favorshme për bujqësi organike. Sipërfaqet me kultura organike të certifikuara janë zgjeruar në Kosovë. Sipas raportit FiBL të vitit 2023, ka rritje prej 24.1%, në total prej 1990 ha, ose 0.5% të sipërfaqes së tokës bujqësore. Ka gjithsej 56 prodhues dhe 19 përpunues, me shumicën e tokës të mbjellë me BMA dhe 136 ha me kultura të tjera. Nga 481,000 ha pyje, 373,488 ha janë të certifikuara për prodhim organik për grumbulluesit e frutave të egra (FiBL IFOAM – Organics International. Statistikat dhe Trendet në Zhvillim në Bujqësinë Organike Botërore 2023).

Kultivimi i BMA-ve dhe mbledhja e produkteve pyjore jo-drusore (PPJD) janë të rëndësishme sepse po zbatohen teknologjitë e qëndrueshme të bazuara në bujqësi po zbatohen. Kjo u lejon fermerëve të certifikuar për prodhim organik të ndajnë njohuritë dhe përvojat e tyre me fermerë të tjerë, duke përfshirë aspektet mjedisore të prodhimit për të cilat shumica e fermave nuk kanë njohuri.

Tregu vendor për produktet organike po zgjerohet, i nxitur nga rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve, dhe produktet organike të

Figura 1: Sipërfaqja e tokës bujqësore të punueshme (ha)





Figura 2: Sipërfaqet e pyllëzuara (ha)



Kosovës po gjejnë mundësi për eksport, veçanërisht në BE. Duhet të përmendet se, përveç kërkesave për eksport, krijimi i pikave grumbulluese dhe subvencionet kanë ndikuar në rritjen e sipërfaqeve organike, me theks të veçantë në kultivimin e BMA-ve. Si rezultat, sektori i BMA-së dhe PPJD-së, mund të shërbejë si model i mirë për zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme dhe transferimin e njohurive në sektorët e tjerë të bujqësisë në Kosovë.

Bashkëpunimi dhe mbështetja ndërkombëtare

Organizata të ndryshme ndërkombëtare, përfshirë BE-në, USAID-in, SDC-në dhe të tjera, ofrojnë mbështetje financiare dhe teknike për sektorin e bujqësisë në Kosovë. Këto programe shpesh përqendrohen në përmirësimin e qëndrueshmërisë, duke përfshirë promovimin e bujqësisë organike, përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe mbështetje për zhvillimin rural. Partnerët ndërkombëtarë janë gjithashtu të angazhuar në trajnime dhe ngritjen e kapaciteteve për fermerët e Kosovës, duke promovuar praktikën më të mira në bujqësinë e qëndrueshme.

3.5. Akterët kryesorë që promovojnë bujqësinë e qëndrueshme

Në Kosovë, disa akterë kryesorë janë të angazhuar në promovimin e bujqësisë së qëndrueshme. Këtu përfshihen institucione qeveritare, organizata ndërkombëtare, OJQ, institucione akademike dhe subjekte të sektorit privat. Secili prej këtyre akterëve luan rol të rëndësishëm në formësimin e politikave, ofrimin e mbështetjes dhe zbatimin e nismave që inkurajojnë praktikën të bujqësisë së qëndrueshme.

INSTITUCIONI	ROLI	NISMAT KRYESORE
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)	Institucioni kryesor qeveritar përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e politikave bujqësore në Kosovë. Ky institucion mbikëqyr programet lidhur me zhvillimin rural, praktikën e qëndrueshme bujqësore, subvencionet dhe mbështetjen për fermerët. MBPZHR, gjithashtu, luan një rol në harmonizimin e politikave bujqësore të Kosovës me standardet e BE-së, që përfshijnë masa për qëndrueshmëri.	Ministria zbaton Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (ARDP), i cili përfshin komponentë të fokusuar për mbrojtjen e mjedisit, bujqësinë organike dhe përdorimin e qëndrueshëm të tokës.
Divizioni për politikën agro-mjedisore dhe zonat më pak të favorizuara (ZPF)	Përgjegjës për krijimin e dokumenteve teknike gjithëpërfshirëse, udhëzuesve dhe udhëzimeve administrative për të mbështetur masat agro-mjedisore në kuadër të programeve ARDP dhe IPARD. Ky divizion, gjithashtu, përfshin koordinimin e fushatave informuese dhe bashkëpunimin me akterë të ndryshëm për të adresuar nevojat e popullsisë në zonat rurale.	Ky divizion ka propozuar skemën agro-mjedisore numër 3, si pilot projekt, për kulltosje verore në kullotat malore, e cila pritet të kushtojë 200,000 euro në vitin 2025, dhe ka për qëllim mbrojtjen e biodiversitetit.
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe	Përgjegjëse për politikën mjedisore, përfshirë menaxhimin e ujit, ruajtjen e biodiversitetit, si dhe disa fusha në	Nismat përfshijnë projekte të menaxhimit të burimeve ujore, përpjekje për ruajtjen

<p>Infrastrukturës (MMPHI)¹²</p>	<p>bujqësi. Ky institucion punon për të siguruar që aktivitetet bujqësore të mos dëmtojnë mjedisin dhe promovon menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve.</p>	<p>e tokës dhe rregullore për të reduktuar ndotjen bujqësore.</p>
<p>Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT)</p>	<p>Agjenci shtetërore kosovare e mandatuar për të promovuar dhe mbështetur investimet, eksportet, turizmin, NVM-të dhe zonat ekonomike në Republikën e Kosovës.</p>	<p>Përveç mbështetjes për investitorët e huaj, përmes skemave të ndryshme të granteve, MINT dhe KIESA, janë të angazhuara për të ofruar mbështetje të vazhdueshme për bizneset në Kosovë, duke ndihmuar që ato të bëhen më konkurruese, përmes ofrimit të produkteve me vlerë të shtuar si dhe duke rritur eksportet në tregun ndërkombëtar.</p>
<p>Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM)</p>	<p>Monitorimi i mjedisit dhe praktikat e qëndrueshme bujqësore për të zvogëluar ndikimet në mjedis.</p>	
<p>Shërbimi Këshillues për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në Kosovë (SHKBZHRK)</p>	<p>Ofron udhëzime të vlefshme dhe trajnime për fermerët mbi praktikat e qëndrueshme bujqësore. Duke aplikuar këto praktika, fermerët mund të rrisin produktivitetin e tyre dhe të promovojnë qëndrueshmërinë në fermat e tyre. Për më tepër, ky shërbim këshillues përdoret vazhdimisht për të arritur objektivat e vendosura në ARDP, të cilat fokusohen në rritjen e të ardhurave bujqësore nga fermat përmes përmirësimit të konkurrueshmërisë në treg, produktivitetit dhe zhvillimit rural.</p>	
<p>Instituti Bujqësor i Kosovës (IBK)</p>	<p>Ofron mbështetje teknike dhe shkencore për departamentet teknike të MBPZHR-së, kontrollin e cilësisë së inputeve bujqësore, ushqimit dhe ruajtjen e mjedisit, dhe hulumtimin e varieteteve të kulturave bujqësore (grurë, elb, misër dhe patate) në kushtet agro-ekologjike të Kosovës. Punimet hulumtuese përfshijnë krijimin e varieteteve të grurit, hibrideve të misrit, etj., punë përgatitore për krijimin e bankës së gjeneve për kultura të</p>	<p>Hulumtime mbi bujqësinë organike, menaxhimin e insekteve dëmtoese të tokës dhe shëndetin e tokës janë disa nga kontributet e IBK-së për bujqësinë e qëndrueshme.</p>

¹²<https://www.mit-ks.net/>

	ndryshme, analizat e tokës, identifikimin dhe inventarizimin e agjentëve biologjikë të dëmshëm të tokës (insekte dëmtuese, patogjenë, barishte etj.), si dhe zhvillimin e teknologjive dhe praktikave bujqësore që promovojnë qëndrueshmërinë dhe rrisin produktivitetin bujqësor.	
Universitetet dhe Institutet kërkimore	Promovojnë inovacion bujqësor, mësojnë dhe trajnojnë profesionistët e rinj të bujqësisë, dhe kryejnë hulumtime mbi bujqësinë e qëndrueshme. Disa universitete po zbatojnë projekte kërkimore për bujqësinë e qëndrueshme dhe janë pjesë e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, duke bashkëpunuar me universitete të shumta në mbarë botën.	Projektet kërkimore përqendrohen në prodhimin e qëndrueshëm të kulturave, menaxhimin e tokës dhe sistemet e bagëtive. Gjithashtu, ofrojnë kurse dhe shërbime shtesë që promovojnë qëndrueshmërinë në bujqësi.
Organizatat Jo-qeveritare (OJQ-të)	Mbështesin praktikat bujqësore të qëndrueshme dhe rrisin njohuritë dhe ndërtimin e kapaciteteve për palët e interesit, duke luajtur kështu një rol të rëndësishëm.	Nismat përfshijnë mbështetje për bujqësinë organike, ofrimin e trajnimeve mbi praktikat e qëndrueshme dhe ndihmën për fermerët për qasje në tregjet për produkte të qëndrueshme.
Oda Ekonomike e Kosovës (OEK)	Analizon situatën ekonomike dhe promovon në mënyrë aktive modele të reja dhe të avancuara të biznesit vendor, si dhe ndërkombëtarizimin e ndërmarrësisë kosovare. Gjithashtu, ndihmon në promovimin e bizneseve dhe në përafrimin e shoqërisë kosovare me parimet evropiane.	
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK)¹³	Zhvillon programe profesionale të akredituara për bujqësi në vitet e fundit (p.sh. prodhimi organik).	
Shoqata 'Organika'	Promovon produktet e saj dhe lobon për eksport në tregjet të huaja, për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet pjesëmarrësve në industri dhe për të avancuar rritjen e sektorit, por edhe për zhvillimin e sektorit të PPJD-së dhe BMA-së, përmes mbledhjes së qëndrueshme të PPJD-ve dhe kultivimit të BMA-ve. ¹⁴	Aktivitetet përfshijnë trajnime për certifikim organik, organizimin e tregjeve për fermerë dhe avokim për politika që mbështesin bujqësinë organike.
Pepeko	Synon të forcojë dhe kontribuojë në	Angazhohet për: Promovimin

¹³<https://akkks.rks-gov.net/>

¹⁴<https://organika-ks.org/en/home/>

	zhvillimin e sektorit të përpunimit të pemëve dhe perimeve në Kosovë, duke përfshirë zbatimin e standardeve të ndryshme të cilat janë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm. ¹⁵	e përpunimit me vlerë të shtuar; mbështetje për standardet e cilësisë dhe certifikim; rritjen e qasjes në treg; avokim dhe ndikim në politika; trajnime dhe ngritje të kapaciteteve; inkurajimin e krijimit të zinxhirëve për furnizim të qëndrueshëm.
Shoqata 'Mjedra e Kosovës'¹⁶	Shoqata që përfaqëson prodhuesit e mjedrës në Kosovë. U krijua për të mbështetur zhvillimin e industrisë së mjedrave, e cila është bërë një pjesë e rëndësishme e sektorit të bujqësisë si rezultat i kërkesës së lartë për mjedra në tregjet vendore si dhe në ato ndërkombëtare.	Përmes mbështetjes së saj për praktikatat e bujqësisë së qëndrueshme, qasjes në treg, kontrollit të cilësisë dhe avokimit, shoqata ndihmon për të siguruar që kultivimi i mjedrave të mbetet një mënyrë jetese e qëndrueshme dhe mjedisore për fermerët në të gjithë Kosovën.
Fondacioni për Zhvillimin e Bujqësisë AgroDev¹⁷	Vepron si OJQ, e përkushtuar për të përmirësuar jetesën e fermerëve dhe komuniteteve në zona rurale, përmes një sërë programesh dhe nismash që synojnë rritjen e produktivitetit bujqësor, qëndrueshmërisë dhe qasjes në treg.	Përmes programeve të saj gjithëpërfshirëse për ngritje të kapaciteteve, qasje në treg, inovacion dhe avokim, AgroDev, mbështet rritjen dhe qëndrueshmërinë e sektorit të bujqësisë në Kosovë, duke kontribuar në mirëqenien e fermerëve dhe popullsisë më të gjerë, në zonat rurale.
Pjesë e AgroDev është AgroPortal¹⁸	Faqja e internetit e AgroDev-it, e cila përmes rrjeteve sociale informon palët e interesit për përfitimet në sektorin e bujqësisë.	
Organizata - Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK)¹⁹	Rrit zhvillimin e mjedisit socio-ekonomik në zonat rurale duke mbështetur aktivitetet bujqësore, ri-integrimin e të riatdhësuarve, zbutjen e varfërisë, zvogëlimin e importeve, promovimin e praktikave të mira bujqësore dhe uljen e papunësisë duke përfshirë të gjitha grupet sociale pa dallim feje, etnie apo gjinie.	
Bashkimi Evropian	Mbështetësi kryesor i bujqësisë së	Projektet e financuara nga

¹⁵<https://pepeko.org/en/about-us/>

¹⁶<https://www.internationalblueberry.org/mjedra-e-kosoves/>

¹⁷https://keptrust.org/en/kep_jobs/agricultural-development-foundation-agrodev-general-manager/

¹⁸<https://agroportal-ks.com/>

¹⁹<https://iadk.org/>

(BE)	qëndrueshme në Kosovë, kryesisht përmes financimit dhe asistencës teknike. Mbështetja e BE-së, lidhet me potencialin e anëtarësimit të Kosovës në BE, e cila kërkon harmonizim me Politikën e Përbashkëta Bujqësore (CAP) me theks të veçantë qëndrueshmërinë.	BE-ja përfshijnë mbështetje për bujqësinë organike, programet e zhvillimit rural dhe nisma që kanë për qëllim përmirësimin e sigurisë ushqimore dhe standardeve mjedisore.
SDC, GIZ-et, Caritas, CNVP, USAID, Care international, Banka Botërore etj.)	Mbështesin zhvillimin e bujqësisë në Kosovë, përmes programeve të ndryshme që synojnë përmirësimin e produktivitetit, qëndrueshmërisë dhe qasjes në treg. Fokusohen shpesh tek fermerët e vegjël dhe zhvillimin e zinxhirit të vlerës.	Nismat përfshijnë projekte për ndërtimin e kapaciteteve, mbështetje për bizneset bujqësore dhe përpjekje për të promovuar praktikën e qëndrueshme në bujqësi.

Pavarësisht se disa akterë të tregut janë veçanërisht të interesuar për bujqësinë e qëndrueshme, do të jetë e rëndësishme që në të ardhmen të bashkëpunojmë me të gjithë akterët e tregut për të promovuar dhe zhvilluar bujqësinë e qëndrueshme në Kosovë.

4. Kornizat rregullatore dhe politikat

4.1. Dokumentet strategjike të Kosovës, kornizat rregullatore dhe politikat relevante për kalimin e sektorit në bujqësi të qëndrueshmëri

Kosova ka një sërë dokumentesh strategjike që theksojnë zotimet për t'i dhënë përparësi qëndrueshmërisë mjedisore; disa prej tyre përshkruajnë drejtpërdrejt objektivat dhe prioritetet specifike të lidhura me bujqësinë e qëndrueshme, ndërsa të tjerat janë më të përgjithshme dhe nuk janë specifike për sektorin.

Një përmbledhje e këtyre dokumenteve është përfshirë në tabelën më poshtë:

DOKUMENTI STRATEGJIK	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	OBJEKTIVI/MISIONI
Strategjia Kombëtare për Zhvillim (NDS) – 2030, miratuar në vitin 2023	Qeveria, duke përfshirë të gjitha ministritë përkatëse për zbatimin e strategjisë	Të arrihet zhvillimi i qëndrueshëm përmes tre shtyllave kryesore: ekonomisë digjitale, ekonomisë qarkore dhe konkurruese; infrastrukturë cilësore, të qëndrueshme dhe të integruar; dhe një mjedis të pastër me përdorim efikas të burimeve natyrore.
Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (SBZHR) 2022-2028	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)	Të avancohen sektorët e bujqësisë dhe zhvillimit rural, me rëndësi të veçantë për përmirësimin e konkurrueshmërisë në industrinë agro-ushqimore, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbështetje për zhvillimin e bizneseve në zona rurale, përmirësimin e sigurisë ushqimore dhe zbatimin e reformave administrative.
Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së	Qeveria	Të përmbushen obligimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), përmes harmonizimit të legjislacionit kombëtar

Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2021-2025		me <i>EU acquis</i> dhe zbatimin e legjislacionit të përafuar. Marrëveshja ka një kapitull veçantë që i dedikohet bujqësisë dhe zhvillimit rural.
Strategjia Kombëtare e Ujërave të Kosovës 2017-2036 (SKUK)	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)	Të ofrohet zhvillim i integruar dhe i qëndrueshëm i sektorit të ujit duke përbushur nevojat për furnizimin me ujë të pijshëm, ujë për prodhimin e ushqimit, për ujitjen e tokave bujqësore, për industri, sport, rekreacion dhe prodhimin e energjisë elektrike.
Sistemi Këshillues i Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (SKKBZHR) 2023-2027	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)	Të mbështetet dhe inkurajohet transferimi i njohurive dhe teknologjive për të rritur produktivitetin, cilësinë, standardet e sigurisë ushqimore, mbrojtjen mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Temat e listuara në këtë strategji përfshijnë: bujqësinë organike, bujqësinë e qëndrueshme, çështjet mjedisore dhe bujqësinë ri-gjeneruese.
Strategjia e Kosovës 2023-2027 (Mbështetur nga EBRD)	Qeveria	Zhvillimi i një sektori privat më konkurrues dhe gjithëpërfshirës për të nxitur rimëkëmbjen dhe rritjen ekonomike; të mbështetet kalimi në një ekonomi të gjelbër në Kosovë përmes kombinimit më të qëndrueshëm të energjisë dhe efikasitetit më të madh të burimeve; Forcimi i integritetit rajonal, lidhjet dhe investimet e huaja. Bujqësia, industria dhe shërbimet: të kryhen reforma në bujqësi, përmirësim në fushën e prodhimit, konkurrueshmërisë në hoteleri dhe turizëm, dhe tregtisë së shërbimeve.
Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023	Qeveria	Përcakton se si të operacionalizohet vizioni për komuna, përmes qeverisjes efikase, edukimit cilësor, mjedisit të pastër, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, mjedisit të përshtatshëm për biznes dhe bujqësi të zhvilluar, në mënyrë që të rritet cilësia e jetës.
Udhërrëfyese i Kosovës për Ekonominë Qarkore	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)	Përkrahur se si bujqësia luan rol në zhvillimin e ekonomisë qarkore.
Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (ARDP)/Programi Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)	Mbështet fuqishëm përpjekjet e Kosovës për të rritur qëndrueshmërinë, për të pasur rritje dhe promovim të zhvillimit të qëndrueshëm. Ofron një kornizë për të adresuar çështjet e zhvillimit rural, për të promovuar qëndrueshmërinë dhe

		maksimizuar potencialin e sektorit të bujqësisë.
Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019-2028 dhe Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike 2019-2021	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)	Politikat për reduktimin e emetimeve të gazrave me efekt serrë (GHG) dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Është një mundësi për të identifikuar dhe zhvilluar zgjidhje për emetimet e gazrave me efekt serrë dhe pasojat e ndryshimeve klimatike, duke përfshirë ato që do të avancojnë zhvillimin e qëndrueshëm.
Plani Kombëtar i Veprimit për Bujqësinë Organike (PKVBO) për 2023–2026	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)	Rritja e proporcionit të tokës së menaxhuar në mënyrë organike, që përfundimisht do të ndihmojë në reduktimin e emetimeve globale të gazrave me efekt serrë dhe do të kontribuojë në biodiversitet.

Në lidhje me bujqësinë e qëndrueshme, dhe pavarësisht se kjo temë përmendet në një numër dokumentesh dhe strategjish, dy dokumentet kyçe që rregullojnë zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme në Kosovë përfshijnë:

Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (SBZHR) dhe Planin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (PBZHR).

Strategjia SBZHR 2022-2028, përfshin një kornizë të politikave gjithëpërfshirëse e orientuar drejt përmirësimit të sektorit të bujqësisë dhe jetesës në zonat rurale në Kosovë. Strategjia është krijuar për të adresuar sfidat kryesore në bujqësi dhe zona rurale, për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe për t'i harmonizuar politikat bujqësore të Kosovës me standardet e BE-së.

SBZHR 2022-2028

Vizioni i SBZHR 2022-2028 është zhvillimi i një sektori agro-rural konkurrues dhe inovativ, i bazuar në njohuri, teknologji dhe standarde moderne, që ofron produkte me cilësi të lartë në tregun e brendshëm, në rajon dhe në BE, si dhe zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe mjedisit, duke ofruar aktivitete ekonomike dhe mundësi punësimi, gjithëpërfshirje sociale dhe cilësi më të mirë të jetesës për banorët në zonat rurale.

Ndërsa SBZHR përcakton qëllimet afatgjata dhe drejtimitet politike për zhvillimin bujqësor dhe rural në Kosovë, PBZHR specifikon veprimet dhe projektet e detajuara që do të zbatohen për të arritur ato qëllime. Me fjalë të tjera, SBZHR ofron kornizën strategjike, ndërsa PBZHR, e përkthen këtë kornizë në veprime dhe projekte konkrete. PBZHR është në thelb plani i zbatimi i nxjerrë nga SBZHR.

Planifikime dhe masa shtesë mbështetëse janë elaboruar në programin kombëtar PBZHR 2023-2027, i cili është subjekt i rishikimeve vjetore në lidhje me proceset e hartimit dhe miratimit të buxhetit vjetor. Çdo vit, një program i ri hartohet nga MBPZHR, që udhëheq zhvillimin rural, i cili specifikon masat mbështetëse në PBZHR.

Objektivat kryesore të strategjisë SBZHR përfshijnë:



Rritjen e konkurrueshmërisë

- **Modernizimi i bujqësisë:** Fokusimi në rritjen e produktivitetit, efikasitetit dhe konkurrueshmërisë së sektorit të bujqësisë përmes inovacioneve teknologjike, përmirësimeve të infrastrukturës dhe qasjes më të mirë në tregje.
- **Mbështetje për fermerët:** Ofrimi i stimujve financiarë, trajnime dhe shërbime këshilluese për fermerët për të adoptuar praktika moderne bujqësore dhe për të përmirësuar cilësinë e prodhimeve të tyre.
- **Zhvillimi i zinxhirëve të vlerës:** Forcimi i gjithë zinxhirit të vlerës bujqësore nga prodhimi, në përpunim dhe tregtim, duke siguruar që produktet të përmbushin standardet ndërkombëtare të cilësisë.



Menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve

- **Mbrojtja e mjedisit:** Promovimi i praktikave të qëndrueshme bujqësore që mbrojnë burimet natyrore, përfshirë tokën, ujin dhe biodiversitetin. Theksi në reduktimin e gjurmës mjedisore të bujqësisë.
- **Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike:** Zhvillimi dhe zbatimi i masave për të ndihmuar fermerët të përshtaten me ndikimet e ndryshimeve klimatike, siç janë ndryshimet e motit dhe rreziku i shtuar nga katastrofat natyrore.



Zhvillimin rural

- **Përmirësimi i infrastrukturës në zona rurale:** Investimi në infrastrukturë përfshirë: rrugët, furnizimin me ujë dhe energji në zonat rurale, për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe për të mbështetur aktivitetet ekonomike.
- **Diversifikimi i ekonomisë rurale:** Inkurajimi i zhvillimit të aktiviteteve ekonomike jo-bujqësore në zonat rurale, siç janë turizmi, prodhimi artizanal dhe ndërmarrjet e vogla, për të krijuar vende pune dhe për të reduktuar varfërinë në zonat rurale.
- **Gjithëpërfshirja sociale:** Fokusimi në mbështetje për grupet e cenueshme në zonat rurale, përfshirë gratë, të rinjtë dhe komunitetet e marginalizuara, duke siguruar qasje të barabartë në burime dhe mundësi.



Përafrimin me standardet e BE-së

- **Harmonizimi me politikat e BE-së:** Përshtatja e politikave bujqësore të Kosovës me Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP) të BE-së, që është thelbësore për procesin e integritimit në BE.
- **Ngritja e kapaciteteve:** Forcimi i kapaciteteve të institucioneve të përfshira në bujqësi dhe zhvillim rural për të zbatuar dhe monitoruar politikat në mënyrë efektive.



Sigurinë ushqimore dhe standardet e cilësisë

- **Përmirësimi i sistemeve të sigurisë ushqimore:** Të sigurohet që ushqimi i prodhuar dhe i shitur në Kosovë i përmbush standardet më të larta të sigurisë, duke e mbrojtur shëndetin publik dhe duke përmirësuar reputacionin e produkteve bujqësore të Kosovës.
- **Promovimi i produkteve vendore:** Mbështetje për brendim dhe tregtim të produkteve bujqësore vendore, si në vend ashtu edhe jashtë vendit.

SBZHR (2022-2028), përmban disa referenca dhe plane specifike për të promovuar **bujqësinë e qëndrueshme**. Këto nisma janë projektuar për të siguruar që praktikat bujqësore në Kosovë të jenë miqësore me mjedisin, ekonomikisht të qëndrueshme dhe të përgjegjshme nga ana sociale. Më poshtë janë disa nga elementet kryesore që lidhen me bujqësinë e qëndrueshme në kuadër të politikave:

Promovimi i praktikave miqësore me mjedisin:

- **Masat agro-mjedisore:** Strategjia thekson adoptimin e masave agro-mjedisore që promovojnë praktika të qëndrueshme bujqësore. Këto përfshijnë rotacionin e kulturave, bujqësinë organike, përdorimin e reduktuar të inputeve kimike (pesticidet dhe plehrat) dhe lëvrimin e tokës.
- **Mbështetje për bujqësinë organike:** Ka një fokus të veçantë në promovimin e bujqësisë organike përmes ofrimit të subvencioneve, trajnimeve dhe mbështetjes për certifikimin e fermerëve. Strategjia synon të rrisë sipërfaqen e kultivimit organik dhe promovimin e produkteve organike në tregjet lokale dhe ato ndërkombëtare.

Menaxhimi i burimeve të qëndrueshme:

- **Ruajtja tokës:** Strategjia përfshin plane për të promovuar teknikat e ruajtjes së tokës, siç janë: lëvrimi i tokës me nivele, tarracimi dhe përdorimi i kulturave mbuluese. Këto praktika ndihmojnë në parandalimin e erozionit të tokës, ruajtjen e pjellorisë së tokës dhe përmirësimin e mbajtjes së ujit.
- **Menaxhimi i ujit:** Përdorimi efikas i ujit është prioritet, me plane për të promovuar sisteme të ujitjes që reduktojnë humbjen e ujit, siç është sistemi i ujitjes pikë-pikë. Gjithashtu, ka masa për të mbrojtur pellgjet e ujërave nga ndotja bujqësore duke kontrolluar rrjedhjet dhe duke menaxhuar mbeturinat e bagëtive.

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike:

- **Bujqësi e qëndrueshme ndaj ndryshime klimatike:** Strategjia identifikon nevojën për të zhvilluar dhe zbatuar praktikat bujqësore të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo përfshin përzgjedhjen dhe promovimin e llojeve të kulturave që janë rezistente ndaj thatësirës, diversifikimin e kulturave për të reduktuar rrezikun nga ndryshimet klimatike, dhe adoptimin e praktikave agro-pyjore që kombinojnë pemët me kulturat për të përmirësuar qëndrueshmërinë.
- **Menaxhimi i rrezikut nga katastrofat natyrore:** Ka plane për të integruar menaxhimin e rrezikut nga katastrofat natyrore në praktikat bujqësore, siç janë sistemet e paralajmërimit të hershëm për ngjarjet ekstreme të motit dhe skemat e sigurimit, për të mbrojtur fermerët nga humbjet e shkaktuara nga ndryshimet klimatike.

Ruajtja e biodiversitetit:

- **Mbrojtja e burimeve gjenetike:** Strategjia përfshin masa për ruajtjen e biodiversitetit bujqësor duke mbrojtur burimet gjenetike lokale të bimëve dhe kafshëve. Kjo përfshin promovimin e varieteteve tradicionale të kulturave dhe racave të bagëtive që janë të përshtatshme për kushtet lokale dhe më rezistente ndaj ndryshimeve mjedisore.
- **Mbrojtja e habitatit:** Po ashtu, bëhen përpjekje për të mbrojtur mjediset natyrore në kuadër të peizazheve bujqësore, duke përfshirë ruajtjen e shkurreve, zonave pyjeve të vogla dhe zonave neutrale përgjatë lumenjve për të mbështetur biodiversitetin.

Menaxhimi i qëndrueshëm i bagëtive:

- **Menaxhimi i kullotave:** Strategjia promovon praktikat e qëndrueshme të kullotjes për të parandaluar mbi-kullotjen dhe degradimin e kullotave. Kjo përfshin sistemet e kullotjes me sistem rotativ dhe restaurimin e kullotave të degraduara.
- **Menaxhimi i lëndëve ushqyese:** Ka plane për të promovuar përdorimin efikas të plehut të kafshëve si pleh organik, duke reduktuar varësinë nga plehurat sintetike dhe minimizuar rrjedhjen e lëndëve ushqyese në pellgjet e ujërave.

Zhvillimi i qëndrueshëm rural:

- **Diversifikimi i burimeve të të ardhurave:** Strategjia inkurajon diversifikimin e burimeve të të ardhurave në zonat rurale duke promovuar agro-turizmin, prodhimin artizanal dhe aktivitete të tjera jo-bujqësore. Kjo ndihmon në reduktimin e presionit mbi tokat dhe burimet bujqësore, duke kontribuar në qëndrueshmërinë e përgjithshme.
- **Ngritja e kapaciteteve dhe edukimi:** Ka një theks të veçantë në edukimin e fermerëve dhe komuniteteve në zonat rurale lidhur me praktikat e qëndrueshme. Kjo përfshin programe trajnimi për bujqësinë e qëndrueshme, menaxhimin e burimeve dhe ruajtjen e mjedisit.

Harmonizimi me standardet mjedisore të BE-së:

- **Pajtueshmëria me direktivat e BE-së:** Strategjia synon të harmonizojë praktikat bujqësore të Kosovës me standardet mjedisore të BE-së, veçanërisht ato të lidhura me përdorimin e qëndrueshëm të tokës, menaxhimin e ujit dhe ruajtjen e biodiversitetit. Ky përafrim është thelbësor për procesin e integritit të Kosovës në BE dhe siguron që praktikat e qëndrueshme të jenë në përputhje me objektivat më të gjera evropiane.

Aktivitetet kërkimore dhe inovacioni:

- **Mbështetje për aktivitete kërkimore:** Strategjia mbështet fushën e kërkimeve dhe inovacionit në bujqësinë e qëndrueshme, duke përfshirë zhvillimin e teknologjive dhe praktikave të reja që mund të përmirësojnë qëndrueshmërinë. Inkurajohet bashkëpunimi me institucione akademike dhe qendra kërkimore për të avancuar njohuritë dhe aplikimin e bujqësisë së qëndrueshme.

Këto referenca dhe plane theksojnë angazhimin e Strategjisë Kombëtare për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të Kosovës, për të promovuar qëndrueshmërinë në sektorin e bujqësisë, duke siguruar që rritja ekonomike të jetë e balancuar me mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien sociale. Megjithatë, zbatimi i këtyre zotimeve mbetet i kufizuar. Kjo është pjesërisht për shkak të mungesës së legjislacionit specifik dhe kuadrit rregullator²⁰ për bujqësi të qëndrueshme, siç e theksojnë akterët kryesorë në nivelin qeveritar.

4.2. Politikat dhe strategjitë e tjera përkatëse

Përpyekjet e Kosovës për bujqësi të qëndrueshme ndikohen nga një sërë politikash të BE-së dhe atyre ndërkombëtare të dizajnuara për të promovuar mbrojtjen e mjedisit, qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Këto politika ofrojnë korniza dhe udhëzime,

²⁰ Informacione të mëtejme mbi rregulloret që kanë të bëjnë me bujqësinë e qëndrueshme janë përfshirë në shtojcën 2.

me të cilat Kosova, mund të përshtatet si pjesë e procesit të saj të integrimit në BE dhe angazhimeve më të gjera ndërkombëtare.

Më poshtë është një përmbledhje e politikave kryesore të BE-së dhe atyre ndërkombëtare, që janë të rëndësishme për bujqësinë e qëndrueshme në Kosovë:

	POLITIKA	PËRSHKRIMI	RËNDËSIA PËR KOSOVËN	ZBATIMI
Politikat e BE-së	Politika e Përbashkët Bujqësore (PPB)	PPB ofron mbështetje financiare për fermerët dhe promovon praktikat bujqësore të qëndrueshme në të gjithë BE-në. Përfshin masa mjedisore, programe për zhvillim rural dhe pagesa direkte për fermerët.	Meqenëse Kosova nuk është anëtare e BE-së, ajo nuk merr pjesë drejtpërdrejt në PPB, por inkurajohet të harmonizojë politikat e saj bujqësore me parimet e PPB-së, si pjesë e procesit të integrimit në BE.	Përafrimi i Kosovës me parimet e PPB-së është në vazhdim e sipër. Përpjekjet përfshijnë adoptimin e praktikave bujqësore të qëndrueshme dhe integrimin e masave mjedisore në politikat kombëtare. Përshtatja është pjesë e procesit më të gjerë të anëtarësimit të Kosovës në BE, i cili përfshin harmonizimin e politikave lokale me standardet e BE-së.
	Marrëveshja e Gjelbër Evropiane	Marrëveshja e Gjelbër, synon neutralitetin ndaj klimës deri në vitin 2050 dhe përfshin objektiva për reduktimin e emetimeve të gazrave me efekt serrë, përmirësimin e biodiversitetit dhe promovimin e sistemeve të qëndrueshme ushqimore.	Kosova inkurajohet të harmonizojë politikat e saj me objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër, për të përmirësuar qëndrueshmërinë mjedisore dhe qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike.	Përafrimi i Kosovës përfshin integrimin e veprimeve për ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit në politikat dhe strategjitë kombëtare. Kosova po punon drejt këtyre objektivave, megjithatë, harmonizimi i plotë është një proces gradual që varet nga reformat e vazhdueshme

				dhe mbështetja e BE-së.
	Strategjia “Nga ferma në pirun”	Kjo strategji është pjesë e Agjendës së Gjelbër dhe fokusohet në krijimin e një sistemi ushqimor të drejtë, të shëndetshëm dhe miqësor me mjedisin. Strategjia synon të reduktojë ndikimin mjedisor të prodhimit të ushqimit dhe të përmirësojë sigurinë ushqimore.	Kosova inkurajohet të adoptojë praktikën që përputhen me strategjinë, siç janë zvogëlimi i përdorimit të pesticideve, promovimi i bujqësisë së qëndrueshme dhe përmirësimi i standardeve të sigurisë ushqimore.	Kosova po bën përpjekje që të përafrohet me këtë strategji duke promovuar bujqësinë e qëndrueshme, duke mbështetur sistemet lokale të ushqimit dhe duke përmirësuar standardet e sigurisë ushqimore. Adoptimi i këtyre praktikave mbështetet nga programe të ndryshme kombëtare me asistencë ndërkombëtare.
	Horizon Europe	Programi Horizon Europe është programi për punë kërkimore dhe inovacioni i BE-së, që financojnë projekte të lidhura me bujqësinë e qëndrueshme, veprimet për ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit.	Kosova mund të marrë pjesë në projektet Horizon Europe ose të harmonizojë prioritetet e saj kërkimore me objektivat e programit, për të pasur qasje në financim dhe ekspertizë për inovacione në bujqësinë e qëndrueshme.	Kosova është angazhuar në aktivitete të lidhura me programin Horizon Europe, përmes bashkëpunimit me institucione kërkimore dhe pjesëmarrjes në projekte të financuara. Ky angazhim ndihmon në nxitjen e inovacionit në bujqësinë e qëndrueshme.
Politikat dhe kornizat ndërkombëtare	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (OZHQKB)	OZHQKB ofron një kornizë globale për zhvillim të qëndrueshëm, me Qëllimin 2, që fokusohet në dhënien fund të urisë dhe promovimin e	Përafrimi me OZHQKB, përfshin zbatimin e politikave që mbështesin bujqësinë e qëndrueshme, sigurinë ushqimore dhe qëndrueshmërinë	Kosova ka përfshirë parimet e OZHQKB në strategjitë kombëtare dhe planet zhvillimore, të lidhura me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim


		bujqësisë së qëndrueshme, dhe Qëllimet 12 dhe 13, që adresojnë konsumin e përgjegjshëm, prodhimin, si dhe veprimet për ndryshimet klimatike.	mjedisore.	(SKZH)/Planin për Zhvillim të Qëndrueshëm 2016-2021 ²¹ , “Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit” dhe “Agjendën Evropiane të Reformave”. Rezoluta mbi OZHQKB është mbështetur zyrtarisht nga Parlamenti i Kosovës, në janar 2018 ²² , duke shënuar kulmin e këtij zotimi.
	Marrëveshja e Parisit	Marrëveshja e Parisit synon të kufizojë ngrohjen globale dhe përfshin angazhime për të reduktuar emetimet e gazrave me efekt serrë dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë klimatike.	Përafrimi i Kosovës me Marrëveshjen e Parisit, kërkon integrimin e veprimeve klimatike në politikat bujqësore, reduktimin e emetimeve nga bujqësia dhe përshtatjen ndaj ndikimeve klimatike.	Kosova po punon në zbatimin e masave për të përmbushur zotimet e saj klimatike në kuadër të Marrëveshjes së Parisit. Kjo përfshin zhvillimin e strategjive për reduktimin e emetimeve të gazrave me efekt serrë dhe përmirësimin e qëndrueshmërinë klimatike në bujqësi.
	Konventa mbi Biodiversitetin Biologjik (KBB)	KBB fokusohet në ruajtjen e biodiversitetit, promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe sigurimin e ndarjes së drejtë	Politikat bujqësore të Kosovës duhet të përfshijnë praktika që mbrojnë biodiversitetin, siç janë: promovimi i kulturave të	Kosova ka bërë përpjekje për përafrim me parimet e KBB-së përmes strategjive kombëtare për biodiversitetin dhe planeve të veprimit, të cilat përfshijnë masa

²¹ https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/10/National_Development_Strategy_2016-2021_ENG.pdf

²² [https://www.kuvendikosoves.org/eng/for-the-public/sustainable-development/the-commitment-of-kosovo//](https://www.kuvendikosoves.org/eng/for-the-public/sustainable-development/the-commitment-of-kosovo/)

		të përfitimeve nga burimet gjenetike.	ndryshme dhe zvogëlimi i përdorimit të pesticideve të dëmshme.	për mbrojtjen dhe promovimin e biodiversitetit në praktikat bujqësore.
	Agjenda 2030	Synon t'i jap fund varfërisë dhe urisë, realizimin e të drejtave të njeriut për të gjithë, arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave, dhe sigurimin e mbrojtjes së qëndrueshme të planetit dhe burimeve natyrore.	Kosova ka konfirmuar zotimin e saj ndaj Agjendës 2030, veçanërisht ndaj OZHQKB dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në përcaktimin e kësaj agjende globale.	Kosova ka vazhduar me planin për të integruar dhe zbatuar OZHQKB, të lidhura me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH)/Planin për Zhvillim të Qëndrueshëm 2016-2021, "Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit" dhe "Agjendën Evropiane të Reformave". Rezoluta mbi OZHQKB është mbështetur zyrtarisht nga Parlamenti i Kosovës, në janar 2018, duke shënuar kulmin e këtij zotimi.
Marrëveshjet rajonale dhe bilaterale	Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor	Agjenda e Gjellbër është një nismë rajonale që synon përafrimin e Ballkanit Perëndimor me Agjendën e Gjellbër të BE-së, duke u fokusuar në mbrojtjen e mjedisit, veprimin klimatik dhe zhvillimin e qëndrueshëm.	Kosova është pjesë e kësaj nisme rajonale, e cila ofron një kornizë për përfshirjen e praktikave të gjelbra në politikat kombëtare dhe bashkëpunimin me vendet fqinje.	Ndërsa Kosova është duke punuar për zbatimin e objektivave të Agjendës së Gjellbër, përmes projekteve të ndryshme kombëtare dhe rajonale, siç thuhet në raportin e Parlamentit Evropian (PE ²³), Kosova duhet të rrisë angazhimin e

²³ <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022/10/Kosovo%20Report%202022.pdf#page=108&zoom=100,93,842>



4.3. Analizë krahasuese e politikave dhe strategjive të Kosovës dhe BE-së

Kosova po bën hapa të rëndësishëm drejt harmonizimit të politikave bujqësore me standardet e BE-së, megjithatë, po përballlet me sfida të konsiderueshme në zbatim, burime financiare dhe përshtatje kulturore, të cilat pengojnë integrimin e saj të plotë në kornizën e BE-së.

Kosova është duke punuar në mënyrë aktive për anëtarësim në BE, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, që përfaqëson një hap të rëndësishëm në këtë proces. Një nga fushat kryesore, ku përafrimi me standardet e BE-së është i nevojshëm është sektori i bujqësisë, i cili mbetet një pikë kyçe e ekonomisë së Kosovës. **Pavarësisht rëndësisë së sektorit, potenciali bujqësor i Kosovës mbetet kryesisht i papërdorur, dhe sektori përballlet me sfida të shumta.** Këtu përfshihet teknologjia e vjetruar, produktiviteti i ulët dhe kapacitetet e kufizuara të eksportit, të cilat së bashku pengojnë konkurrueshmërinë me tregjet rajonale dhe ato të BE-së.

Për t'i adresuar këto sfida, Kosova ka zhvilluar Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028, e cila synon të harmonizojë politikat e saj bujqësore me Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB) të BE-së. Kjo strategji është thelbësore për Kosovën, pasi synon të përmirësojë shfrytëzimin e burimeve, të rrisë konkurrueshmërinë në sektorin e bujqësisë dhe gradualisht të përafroj rregulloret e saj me standardet e BE-së. **Megjithatë, politikat bujqësore të Kosovës aktualisht përputhen vetëm me katër nga dhjetë objektivat e paraqitura në PPB, që reflekton shkallë të kufizuar të integritit.** Ndërsa politikat e Kosovës përqendrohen shumë në rritjen e produktivitetit dhe sigurinë ushqimore, PPB e BE-së ka evoluar dhe thekson qëndrueshmërinë mjedisore, zhvillimin rural dhe konkurrueshmërinë. Hendeku më i madh në përafrim vërehet në fushën mjedisore, ku përpjekjet e Kosovës për ruajtjen e biodiversitetit, zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme janë minimale në krahasim me standardet e BE-së. SBZHR prezanton masa për t'i adresuar disa nga këto çështje, siç janë investimet në energjinë fotovoltaike, objektet për ruajtjen e plehrave dhe përmirësimin e mirëqenies së kafshëve, por akoma mbetet shumë më tepër për t'u bërë.

Sa i përket fushave specifike të përafrimit, SBZHR e Kosovës, paraqet përparim në disa fusha kryesore. Për shembull, strategjia i jep jehonë objektivave të PPB të BE-së duke promovuar bujqësinë organike, menaxhimin e qëndrueshëm të tokës dhe përdorimin efikas të ujit; të gjitha këto janë kritike për qëndrueshmërinë mjedisore dhe veprim mjedisor. Këto

përpjekje janë të harmonizuara me nismat më të gjera të BE-së, siç është Agjenda e Gjelbër Evropiane dhe Strategjia “Nga ferma në pirun”, të cilat synojnë ta bëjnë bujqësinë më të qëndrueshme duke zvogëluar emetimet e gazrave me efekt serrë dhe duke përmirësuar biodiversitetin.

Strategjia e Kosovës gjithashtu përputhet me objektivat e BE-së për biodiversitetin dhe shërbimet e ekosistemit duke i dhënë prioritet ruajtjes së burimeve gjenetike lokale të bimëve dhe kafshëve dhe promovimit të praktikave tradicionale bujqësore që janë të dobishme për biodiversitetin. **Megjithatë, efikasiteti i këtyre masave varet shumë nga fuqia e zbatimit të tyre, e cila mbetet sfidë për Kosovën.** Po ashtu, SBZHR e Kosovës e mbështetë zhvillimin rural dhe gjithëpërfshirjen sociale, si dy nga objektivat kryesorë të PPB-së së BE-së. Strategjia përfshin nisma për përmirësimin e infrastrukturës në zonat rurale, promovimin e diversifikimit të të ardhurave përmes agro-turizmit dhe mbështetjes së grupeve të cënueshme, duke përfshirë gratë dhe fermerët e rinj. Këto nisma reflektojnë theksin e BE-së, mbi zhvillimin e balancuar në zonat rurale, duke siguruar që përfitimet nga rritja bujqësore të ndahen gjerësisht.

Në fushën e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit, PBZHR e Kosovës, përcakton objektivat për forcimin e sistemeve të sigurisë ushqimore dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve bujqësore, në përputhje me standardet e BE-së, që kanë prioritet sigurinë e lartë ushqimore, gjurmueshmërinë dhe cilësinë. Për më tepër, strategjia synon të modernizojë sektorin e bujqësisë duke nxitur inovacionin, përmirësimin e qasjes në teknologjitë moderne dhe përmirësimin e qasjes në treg, që është në përputhje me fokusin e BE-së mbi konkurrueshmërinë ekonomike dhe inovacionin.

Megjithatë, pavarësisht këtyre fushave të përafrimit, Kosova përballet me sfida të konsiderueshme në harmonizimin e plotë të politikave të saj bujqësore me ato të BE-së. Një pengesë kryesore është kapaciteti i kufizuar për zbatimin efektiv të politikave. **Institucionet e Kosovës, të cilat janë përgjegjëse për bujqësinë, mjedisin dhe zhvillimin rural, shpesh nuk kanë staf, ekspertizë dhe burime të nevojshme të mjaftueshme për të zbatuar dhe monitoruar harmonizimin me politikat e BE-së.** Për më tepër, kuadri ligjor i vendit ende nuk është plotësisht i harmonizuar me direktivat e BE-së, veçanërisht në fusha kritike si: menaxhimi i ujit dhe rregullimi i pesticideve. Për shembull, përderisa BE ka rregulla strikte për përdorimin e pesticideve, Kosova është ende në procesin e harmonizimit të plotë të rregulloreve, duke përfshirë ndalimin e substancave të dëmshme dhe promovimin e praktikave të integruara për menaxhimin e insekteve të dëmshme.

Kufizimet financiare i komplikojnë më tej përpjekjet e Kosovës për t'u harmonizuar me standardet e BE-së. Arritja e nivelit të investimeve të nevojshme për bujqësi të qëndrueshme dhe mbrojtjen e mjedisit është e vështirë duke pasur parasysh financimin e kufizuar publik në vend. Mbështetja e Kosovës në burimet e jashtme të financimit, si fondet e Instrumentit për Ndihmën para Anëtarësimin (IPA), është thelbësore, por këto fonde shpesh janë të pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha nismat e nevojshme. Për më tepër, boshllëqet teknologjike dhe infrastrukturore në zonat rurale, siç janë rrugët e papërshtatshme, sistemi i ujitjes dhe objektet për menaxhimin e mbeturinave, pengojnë më tej përdorimin e praktikave bujqësore të qëndrueshme.

Një pengesë tjetër e rëndësishme për harmonizimin e plotë është mungesa e ndërgjegjësimit dhe rezistenca ndaj ndryshimeve në mesin e fermerëve të Kosovës. Shumë fermerë, veçanërisht ata në zona rurale, janë të mësuar me praktikatat tradicionale bujqësore dhe mund të ngurrojnë aplikimin e metodave të reja, më të qëndrueshme që përputhen me standardet e BE-së. Kjo rezistencë është e përforcuar nga mungesa e trajnimeve dhe

shërbimeve mbështetëse, të cilat janë thelbësore për edukimin e fermerëve mbi përfitimet e praktikave të qëndrueshme dhe mënyrën se si t'i zbatojnë ato në mënyrë efikase.

Përrjashtimi i Kosovës nga programi IPARD III, një nismë e BE-së që ofron ndihmë financiare për zhvillimin rural për vendet kandidatë dhe ato me potencial për anëtarësim, thekson sfidat me të cilat përballet vendi në përpjekjet për integrim në BE. Sipas PBZHR 2023-27, Kosova aktualisht nuk është përfituese e programit IPARD, dhe të gjitha masat financohen përmes buxhetit kombëtar derisa të arrihet akreditimi për zbatimin e masave IPARD²⁴. Një nga arsyt kryesore është kapaciteti institucional aktual i Kosovës dhe kuadri ligjor, i cili ende nuk është zhvilluar plotësisht për të përmbushur kërkesat strikte të menaxhimit të fondeve IPARD.

Megjithatë, përkundër këtyre sfidave, Kosova vazhdon të marrë mbështetje përmes fondeve më të gjera IPA, të cilat janë thelbësore për ngritjen e kapaciteteve, reformën institucionale dhe zhvillimin e infrastrukturës. Megjithatë, pa qasje në IPARD III, Kosova humbet mundësinë e jashtëzakonshme për të rritur bujqësinë e qëndrueshme përmes subvencioneve, granteve dhe ndihmës teknike që janë thelbësore për harmonizim me standardet e BE-së.

Si përfundim, ndonëse Kosova ka bërë përparim të dukshëm në përafrimin e politikave bujqësore me ato të BE-së, akoma mbeten shumë sfida të mëdha. Këto përfshijnë boshllëqe në harmonizim legjislativ, kapacitete institucionale, burime financiare dhe gatishmërinë kulturore. Adresimi i këtyre sfidave kërkon përpjekje të qëndrueshme dhe angazhim më të fortë diplomatik për të integruar plotësisht Kosovën në kornizën e BE-së dhe për të realizuar qëllimin e saj për anëtarësim në BE.

5. Vlerësimi i gatishmërisë së sektorit të bujqësisë

5.1. Praktikave dhe nismat ekzistuese të qëndrueshmërisë të zbatuara nga NVM-të në sektorin bujqësor në Kosovë

Ky studim ka identifikuar disa praktika të qëndrueshme që janë gjerësisht të adoptuara dhe aktualisht po zbatohen nga fermerët, qendrat grumbulluese, përpunuesit dhe palët e tjera të interesit. Praktikave të zakonshme të vëzhguara gjatë punës në terren, përfshirë diskutimet në grupe të fokusuara dhe intervistat me informatorë kryesorë, **përfshijnë investime në panelet diellore, përdorimin e plehrave organikë, sistemin e ujitjes pikë-pikë, teknologjitë inteligjente të ujitjes, ruajtjen e plehurat organik, pajisjet për shpërndarjen e plehurat organik, bio-stimuluesit dhe varietete të rezistueshme të kulturave.** Gjithashtu, është inkurajuese të shohim se disa anëtarë të zinxhirit të vlerës po i respektojnë standardet si: Global GAP, IPM, GRASP, GACP, IFS, BRC dhe ISO 22000, madje disa prej tyre që janë certifikuar si organikë. Më poshtë ofrohet një përmbledhje e praktikave kryesore në katër nën-sektorët e analizuar, me praktikave specifike të detajuara për secilin nën-sektor.

Panelet diellore

Varësisht nga nën-sektori, energjia elektrike përdoret kryesisht për ujitje, ndriçim, ngrirje dhe funksionimin e pajisjeve dhe makinave të ndryshme në fermë. Në pjesën e prodhimit primar të zinxhirit të vlerës, shumë ferma në të gjithë vendin kanë instaluar panelet diellore për të prodhuar energji elektrike dhe për ngrohjen e ujit, kryesisht përmes skemës së granteve të MBPZHR-së. Këto investime synojnë të reduktojnë varësinë nga burimet tradicionale të energjisë dhe të ulin faturat e energjisë elektrike. Nuk ka asnjë lidhje ndërmjet madhësisë së

²⁴ <https://www.mbpzhr>

ks.net/repository/docs/NATIONAL_PROGRAM_FOR_AGRICULTURE_AND_RURAL_DEVELOPMENT_20232027.pdf

fermës dhe paneleve diellore²⁵ të instaluar përmes kësaj skeme të grantit. Megjithatë, efikasiteti i këtyre paneleve mbetet i kufizuar, kryesisht për shkak të cilësisë së sistemeve të instaluar dhe mos përputhjes midis kapaciteteve të paneleve dhe nevojave të konsumit të energjisë së fermave.

Sa i përket kompanive përpunuese, gati të gjitha kompanitë që përdorin panele diellore, janë mbështetur me grante për instalimin e tyre, përveç një kompanie përpunuese që ka investuar fondet e saj për të instaluar panele diellore dhe tani me sukses po gjeneron kapacitete të mjaftueshme për t'i mbuluar të gjitha nevojat për energji elektrike. Meqenëse në këtë studim, nuk kemi mundur të japim numrin e saktë të objekteve përpunuese, palët e interesit vlerësuan se deri tani, gati gjysma e objekteve përpunuese kanë instaluar panele diellore me kapacitet të ndryshëm, ku 70% është dedikuar për prodhim të energjisë elektrike dhe 30% për ngrohje të ujit.

Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave është një aspekt thelbësor i prodhimit të bujqësisë, megjithatë shumica e prodhimit primar (fermat) nuk kanë masa për trajtim të mbeturinave. Për më tepër, ndërgjegjësimi i fermerëve në këtë fushë mbetet i kufizuar. Megjithatë, nën-sektori i bylmetit bën përjashtim me disa raste të praktikave të mira, ku fermerët kanë investuar në ndërtimin e magazinave për plehra dhe gropave septike për të menaxhuar siç duhet plehun dhe mbeturinat. Këto iniciativa janë nxitur kryesisht përmes granteve nga MBPZHR ose organizatat donatore. Në pjesën e prodhimit sekondar, shumica e përpunuesve kanë bërë investime për trajtimin dhe/ose ruajtjen e mbeturinave, kryesisht duke investuar në impiante për trajtimin e ujit sanitar dhe instalimin e gropave septike për qëllime kompostimi. Po ashtu, si në pjesën e prodhimit primar, këto investime janë nxitur kryesisht nga grantet.

Sistemi i ujitjes

Ujitja përmes sistemit pikë-pikë po përdoret nga fermerët, kryesisht për kultivimin e frutave, disa bimëve mjekësore dhe kulturave të tjera shumëvjeçare, ndërsa përdorimi i këtij sistemi të ujitjes për kultivimin e kulturave vjetore është ende në fazat e saj të hershme. Perimet kryesisht ujitën me sistem spërkatës në zona të rregulluara, megjithatë, ujitja tradicionale me kanale mbetet e zakonshme. Praktikata e ujitjes varen gjithashtu nga madhësia e fermës, me fermerët e vegjël që shpesh përdorin kanale, ndërsa fermat më të mëdha investojnë në pajisje të ndryshme për ujitje. Megjithatë, uji që përdoret për ujitje nuk analizohet, përveç nëse kërkohet, për të përmbushur standarde specifike.

Ujitja me sistemin pikë-pikë është një metodë efikase për menaxhimin e ujit, pasi ajo e dërgon ujin drejtpërdrejt në rrënjët e bimëve, duke minimizuar humbjet dhe duke siguruar përdorimin efikas të ujit. Megjithatë, ka raste kur fermerët përdorin ujë direkt nga kanalet publike pa masa konkrete për të monitoruar ose kontrolluar sasinë e ujit që po përdoret.

Plehu organik

Një numër në rritje i fermerëve po përdorin plehra organike në vend të atyre sintetike, duke çuar në rendimente më të larta dhe tokë më të shëndetshme. Përdorimi i plehrave organike, kryesisht të nxjerrë nga plehu i bagëtive, po shfaqet në disa nën-sektorë si një praktikë e

²⁵ Deri para dy vitesh, fermerët në prodhimin primar mund të ndanin 5% të investimit të tyre total për energjinë diellore për të marrë nga 5 deri në 10 pikë shtesë në vlerësimin e aplikimit, ndërsa industria përpunuese duhej të ndante 10% për të marrë 10 deri në 20 pikë shtesë. Në dy vitet e fundit, skema e granteve ka ndryshuar pak, duke i lejuar fermerët të instalojnë panele diellore me **kapacitet deri në 120% të nivelit të tyre të konsumit**. Megjithatë, kërkesa për të investuar të paktën 5% të investimit total në energjinë diellore mbetet në fuqi dhe shumica e fermerëve vazhdojnë ta ndjekin këtë opsion.

zakonshme. Ka gjithashtu raste ku përdoret plehu i pulave si pleh organik. Ky kalim në opsione organike ka kontribuar në zvogëlimin e përdorimit të plehrave kimikë, duke promovuar praktika më të qëndrueshme bujqësore dhe minimizuar ndikimin e tyre në mjedis. Përdorimi i plehrave organikë mund t'i atribuohet një tradite të gjatë të aplikimit të tyre, disponueshmëria e tyre, përballueshmëria (efektshmëria me kosto) dhe promovimi nga shërbimet private dhe publike. Megjithatë, sasia e përdorur nuk kontrollohet dhe nuk është e bazuar në analizat e tokës. Tabela më poshtë rendit gjetjet kryesore si praktika të qëndrueshme ekzistuese sipas nën-sektorit.

SEKTORI	VËSHTRIMET KRYESORE
Bylmeti	<ul style="list-style-type: none"> • Shumë ferma të qumështit kanë instaluar panele diellore në çati, dhe disa fermerë kanë instaluar panele diellore për ngrohjen e ujit. • Disa fermerë kanë investuar në sisteme për menaxhim të mbeturinave, veçanërisht në depo të dedikuara për ruajtjen dhe trajtimin e plehut. Megjithatë, depot e plehut ishin funksionale vetëm në fermat e pajisura me makineri për shpërndarjen e plehut. Fermerët që nuk kanë pajisje të tilla nuk e kanë shfrytëzuar depozitimin e plehut. • Fermerët e qumështit kanë marrë pjesë në programe trajnimi mbi praktikën e qëndrueshme, duke çuar në përdorimin e qasjeve të reja, përfshirë përmirësimin e menaxhimit të plehut, përdorimin e plehrave organikë dhe menaxhimin më të mirë të përgjithshëm të fermës. • Fabrikat më të mëdha të qumështit (5-7) kanë investuar në sisteme për trajtimin e mbeturinave, duke i drejtuar investimet kryesisht në objektet për trajtimin (impiantet²⁶) e ujërave të shkarkuara. Ndërsa shumica e këtyre sistemeve janë financuar përmes granteve nga MBPZHR ose donatorë të tjerë, ka një rast të një fabrike të qumështit, që e ka financuar në mënyrë të pavarur ndërtimin e një impianti të tillë. • Po ashtu, fabrikat më të mëdha të qumështit kanë instaluar panele diellore, dhe një kompani përpunuese ka investuar në një sistem diellor duke përdorur fondet e veta. • Shkarkimi i hirrës mbetet një sfidë e madhe për industrinë e qumështit, pasi shumë fabrika qumështi nuk kanë kapacitet financiar dhe infrastrukturor për trajtimin e hirrës. Si një zgjidhje praktike, tre fabrika të qumështit kanë prodhuar dhe tregtuar një produkt të njohur si “kumësht”, duke ricikluar një pjesë të hirrës dhe duke reduktuar kështu sasinë që shkarkohet.
Perimet	<ul style="list-style-type: none"> • Prodhuesit e perimeve po përdorin gjithnjë e më pak pesticide. Kjo është nxitur nga reduktimi i problemeve nga insektet dëmtuese, si dhe nga përmbushja e standardeve Global GAP, për ata që janë të certifikuar. • Kohët e fundit, aplikimi i plehrave bio është rritur, për shkak të ofertave nga tregtarët. • Disa fermerë, me mbështetje nga MBPZHR, kanë filluar të përdorin ‘kurthe’ për insekte për prodhimin e specave. • Qendra grumbulluese e perimeve ofron këshilla për fermerët mbi përdorimin e duhur të pesticideve dhe plehrave, si dhe ofron kontrata për shitjen e produkteve të tyre. • Përdorimi i praktikave të qëndrueshme bujqësore, duke përfshirë standardet (p.sh. Global GAP, IPM, Organike, etj.), është kryesisht i nxitur nga kërkesa e tregut për produkte më të shëndetshme.

²⁶ Në gjuhën e industrisë, këto objekte njihen si ‘impiante’.

	<ul style="list-style-type: none"> • Shumica e përpunuesve të perimeve kanë objekte për trajtimin e ujit sanitar, dhe disa gjithashtu kanë instaluar panele diellore, ngjashëm me industrinë e tjera bujqësore.
<p>Fruta të buta</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Disa fermerë përdorin plehra organikë, që buron kryesisht nga feramat e bagëtive afër parcelave të tyre. • Përafërsisht 90% e fermerëve përdorin foli plastike, e cila çon në zvogëlimin e përdorimit të herbicideve; megjithatë, mbeturinat plastike mbeten problem. • Kultivimi i mjedrës ka përdorim të kufizuar të pesticideve, ku shumica e fermerëve që aplikojnë vetëm një fungicid dhe një insekticid. • Pavarësisht vështirësive në prodhim, ata mbajnë rregullisht trajnime, kryesisht të ofruara nga shoqata 'Mjedra e Kosovës', duke përfshirë disa tema për praktikën e qëndrueshme (p.sh. përdorimi i bio-stimuluesve). • Fermerët e mjedrës janë gjithnjë e më të ndërgjegjshëm dhe shpesh kërkojnë informacione mbi ujitjen dhe pesticidet. Ata kryesisht marrin këshilla nga ekspertët e shoqatës ose specialistë të tjerë, shpesh të punësuar nga organizata donatore. • Njëra nga qendrat grumbulluese zvogëlon mbeturinat duke ia shitur kërcellin e dredhëzave një prodhuesi të çajit në Prizren, i cili i ripërdor ato në një produkt të tregtueshëm. • Një fermer i specializuar për kultivimin e frutave të buta ka investuar në një sistem inteligjent për ujitjeje, duke përfshirë teknologji të avancuar. Ky investim është nxitur nga njohuritë e fituara gjatë vizitave në feramat e ndryshme në rajon dhe në BE. Sistemi ofron ujitje dhe plehërim të saktë, duke u kalibruar sipas nevojave specifike dhe zonave të fermës. Fermeri është shumë i kënaqur me eficientësinë dhe efikasitetin e këtij sistemi. • Sensorët e lagështisë janë instaluar nga 4-5% të fermerëve të frutave të buta në vend. • Më parë, kultivuesit e mjedrës kultivonin varietete pranverore, por tani ata përdorin ekskluzivisht varietete vjeshtore për shkak të përshtatshmërisë për klimën aktuale në vend. Varietetet pranverore shpesh dëmtoheshin nga ngrica, duke e bërë varietetin vjeshtor një zgjedhje më të mirë për kushtet klimatike të Kosovës. • Një qendër grumbulluese ka instaluar panele diellore 30 kW, të cilat tani plotësojnë 70% të nevojave për energji dhe kanë zvogëluar shpenzimet e energjisë elektrike me 70-80%. Ky investim është financuar pjesërisht nga pronari, dhe 70% e shpenzimeve është mbuluar përmes një granti nga Caritas. Pronari ka pranuar se fillimisht nuk e kishte ditur vlerën e këtij investimi, por tani e kupton rëndësinë e saj. • Aktualisht, 0.50 ha e mjedrës organike kultivohet në Kosovë. • Fermerët përballen me sfida për ujitjen e mjedrës, por kanë marrë trajnime mbi përdorimin efiçient të ujit.
<p>Bimët Mjekësore Aromatike (BMA)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Fermerët me fusha të mëdha aplikojnë plehra të gjelbërt. • Të gjithë fermerët që kultivojnë BMA janë të certifikuar si prodhues organikë. • Ata nuk kanë probleme me insektet dëmtuese, dhe përdorin plehra bio (kryesisht të importuar) dhe pleh organik (nga feramat afër), si dhe komposto të prodhuar nga mbeturinat e pastrimit të bimëve. • Rotacioni i kulturave praktikohet nga të gjithë fermerët; është më shumë një kërkesë e trupit certifikues, por ka pasur ndikim në rritjen e vetëdijes së fermerëve.

- Fermerët e mëdhenj përdorin panele diellore për energji (kryesisht në pikat e grumbulluese për ruajtjen e produkteve) dhe sisteme inteligjente për ujitje, por jo edhe fermerët e vegjël. Shoqata 'Organika' organizon trajnime për bujqësi organike që përqendrohen në teknologjitë e reja dhe kërkesat e reja për certifikim.

Si përmbledhje, përvetësimi e këtyre praktikave të qëndrueshmërisë është nxitur kryesisht nga grantet për investime nga institucionet publike ose organizatat donatore. Gjithashtu, kjo është nxitur edhe presioni i organeve përkatëse rregullatore dhe zbatuese, siç janë ministritë dhe autoritetet lokale—përfshirë MINT, MBPZHR, inspektoratet e tyre, Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, dhe/ose inspektorët komunalë.

Megjithatë, trendet e ardhshme për këto praktika nuk duket shumë premtuese, pasi fermerët duket se janë fort të varur nga grantet. Në mungesë të këtij financimi, shumica e fermerëve nuk i shohin këto praktika si prioritet për investimet e ardhshme.

5.2. Sfidat dhe pengesat me të cilat përballen NVM-të bujqësore në Kosovë për përdorimin e praktikave të qëndrueshme.

Fermerët në Kosovë përballen me shumë sfida për zbatimin e praktikave të bujqësisë së qëndrueshme. Sfidat kryesore përfshijnë mungesën modeleve ekzistuese të fermave të qëndrueshme, shqetësimet për qëndrueshmërinë ekonomike, boshllëqet në ndërgjegjësim dhe trajnim, mbështetje teknike të pamjaftueshme, përvojë paraprake me disa nga praktikat e qëndrueshme, dhe mbështetje të pamjaftueshme rregullatore dhe institucionale. Më poshtë janë përshkrimet e hollësishme të këtyre sfidave kryesore.

Mungesa e fermave model

Një sfidë madhore për promovimin e bujqësisë së qëndrueshme në Kosovë është mungesa e fermave model, që zbatohen me sukses dhe përfitojnë nga praktikat e qëndrueshme. Sipas informacioneve të mbledhura gjatë punës në terren, nuk ka shembuj të njohur të fermave të prodhimit primar, që kanë zbatim të suksesshëm dhe fitimprurës të këtyre praktikave, përveç disa fermave të prodhimit organik. Fermat e tjera që në një farë mase zbatohen praktikat e qëndrueshme janë kryesisht ato ferma që mbështeten përmes skemave specifike të granteve, siç janë investimet në panele diellore dhe magazinat e plehrave. Për më tepër, disa fermerët kanë përfituar nga projekte të ndryshme për pajisje që përdorin sisteme inteligjente të ujitjes dhe mbështetje për analizimin e pjellorisë së tokës. Megjithatë, funksionaliteti i këtyre investimeve mbetet një sfidë e madhe. Prandaj, fermerët shpesh pengohen për përdorimin e metodave të qëndrueshme, për shkak të mungesës së shembujve konkretë, që mund t'i vëzhgojnë dhe të mësojnë prej tyre. Mungesa e fermave funksionale dhe fitimprurëse që veprojnë sipas modeleve të qëndrueshme, tregon se nuk ka shembuj konkretë, për të demonstruar realizueshmërinë dhe përfitimet e këtyre praktikave. Pa këto ferma model, fermerët kanë vështirësi të imagjinojnë suksesin potencial të përdorimit të praktikave të qëndrueshme, duke penguar zbatimin dhe pranimin më të gjerë brenda komunitetit bujqësor.

Kthimi i investimeve

Qëndrueshmëria ekonomike përbën një sfidë tjetër thelbësore për përdorimin e praktikave të qëndrueshme në sektorin e bujqësisë në Kosovë. Fermerët shpesh hezitojnë të zbatojnë praktika të qëndrueshme për shkak të besimit të perceptuar prej kohësh, se këto praktika nuk kanë përfitim ekonomik. Shumë prej tyre janë mësuar me një grup specifik të praktikave bujqësore dhe janë rezistentë ndaj ndryshimeve. Fermerët shprehin besimin se do të përballen me humbje nëse kalojnë në praktika të reja dhe më të kushtueshme. Prandaj, pa përfitime të

qarta ekonomike, fermerët hezitojnë të ndryshojnë praktikat e tyre të prodhimit, pasi përfitimi financiar shpesh është motivuesi kryesor për ndryshim për fermerët në Kosovë. Për të inkurajuar adoptimin e praktikave të qëndrueshme, është thelbësore të demonstrohet potenciali i tyre ekonomik, duke i përkthyer praktikat konkrete të qëndrueshme në terma financiarë të matshëm. Derisa fermerët shohin një avantazh të qartë ekonomik, ata vështirë se bëjnë ndryshime të nevojshme në praktikat e tyre bujqësore. Gjithashtu, fermerët duan të sigurohen që produktet e tyre të shiten; shumica e fermerëve janë të gatshëm të zbatojnë teknologji të reja në prodhim, pasi të kenë krijuar treg.

Ndërgjegjësimi, trajnimi dhe mbështetja teknike

Një pengesë tjetër për përdorimin e praktikave të bujqësisë së qëndrueshme në Kosovë është mungesa e ndërgjegjësimit dhe mbështetja teknike në dispozicion për fermerët. Shumë fermerë nuk janë plotësisht të vetëdijshëm për dëmin mjedisor që shkaktojnë praktikat e tyre aktuale bujqësore, gjë që në një farë mënyre pengon motivimin e tyre për ndryshim. Përveç kësaj, ka mungesë të theksuar të stafit teknik për të ndihmuar fermerët në zbatimin e metodave të qëndrueshme, gjë që krijon vështirësi për shfrytëzimin efikas të teknologjive dhe praktikave të reja. Hendeku i njohurive dhe trajnimeve mbi praktikat e qëndrueshme dhe përdorimin e duhur të pajisjeve e përkeqëson më tej situatën. Pa mbështetjen e duhur dhe të shtuar teknike dhe ndërgjegjësim më të gjerë, fermerët do të kenë vështirësi të kalojnë në zbatimin e praktikave më të qëndrueshme, duke e ngadalësuar kështu përparimin e sektorit.

Shfrytëzimi i investimeve të mëparshme

Shfrytëzimi efikas i investimeve të mëparshme për praktikat e bujqësisë së qëndrueshme, siç janë panelet diellore dhe magazinat e plehrave, mbetet një sfidë e rëndësishme. Shumë fermerë e kanë shfrytëzuar pak mbështetjen e ofruar përmes skemave të granteve për shkak të mungesës së njohurive dhe asistencës. Për shembull, në rastin e paneleve diellore, instalimet e paefektshme, të karakterizuara nga kapacitete të papërshtatshme ose cilësi të dobët, janë të zakonshme në mesin e fermerëve, gjë që shpesh çon në investime të humbura. Përveç kësaj, shumica e këtyre investimeve janë realizuar përmes granteve, dhe fermerët mbështeten në këto grante si burimi kryesor i financimit për investime të tilla. Prandaj, përkundër faktit se shumica e këtyre investimeve financohen nga grante, shumë fermerë janë skeptikë për efikasitetin e këtyre teknologjive, për shembull, në rastin e paneleve diellore si burim të besueshëm i energjisë²⁷. Gjithashtu, hezitimi i fermerëve për të investuar nga fondet e tyre përbën një pengesë tjetër për përdorim më të gjerë të këtyre teknologjive. Ky skepticizëm, i kombinuar me ndihmën teknike të papërshtatshme dhe hezitimin nga ana e fermerëve për të investuar nga fondet e tyre, rezulton në shfrytëzimin e paefektshëm të këtyre burimeve. Mungesa e mbështetjes së mjaftueshme rregullatore dhe institucionale e përkeqëson më tej problemin, duke ia pamundësuar fermerëve të përfitojnë plotësisht nga teknologjitë që synojnë përmirësimin e qëndrueshmërisë.

Mbështetja rregullatore dhe institucionale

Mbështetja rregullatore dhe institucionale për praktikat e bujqësisë së qëndrueshme në Kosovë është e pamjaftueshme dhe jo adekuate, me boshllëqe të dukshme në lidhjen dhe mbështetjen nga institucionet publike. Ka masa dhe rregullore jo adekuate për të siguruar zbatimin efektiv të praktikave të qëndrueshme, gjë që minon përpjekjet për të promovuar qëndrueshmërinë. Për

²⁷ Shembuj të tjerë përfshijnë investime të tilla si mbulesa plastike, të cilat përbëjnë vështirësi shtesë për shkak të mbetjeve plastike dhe sistemet inteligjente të ujitjes të financuara nga donatorë të ndryshëm janë përballur me probleme për shkak të problemeve të mirëmbajtjes së pajisjeve.

më tepër, kuadri aktual ligjor zbatohet dobët, duke rezultuar në mungesë të zbatimit dhe efikasitetit.

Tabela më poshtë rendit sfidat dhe pengesat kryesore me të cilat përballen fermerët, qendrat grumbulluese, përpunuesit dhe palët e tjera të interesit në katër nën-sektorë të ndryshëm që janë pjesë e këtij studimi.

SEKTORI	VËSHTRIMET KRYESORE
Bylmeti	<ul style="list-style-type: none"> • Ka pasur përpjekje minimale për zbatimin e praktikave të bujqësisë së qëndrueshme në sektorët e bagëtive dhe qumështit, me fermerët që mbeten kryesisht të painformuar për përfitimet dhe efektet mjedisore që lidhen me këto praktika. • Shumica e plehut organik në fermat e bagëtive mbetet i papërpunuar. • Fermerët shpesh përfshinin objekte për ruajtjen e plehut gjatë aplikimit për grante nga MBPZHR, vetëm për të fituar pikë shtesë, por shumica e këtyre objekteve për ruajtjen e plehut tani janë të papërdorura, kryesisht për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm dhe mungesës së pajisjeve të nevojshme për shpërndarjen e plehut. • Në mënyrë të ngjashme, për panelet diellore, fermerët kanë përfshirë panelet diellore në aplikimet e tyre për grante nga MBPZHR, vetëm për të fituar pikë shtesë, ndërsa 90% e kapaciteteve të instaluara në fermat e qumështit, nuk janë funksionale ose ka mospërputhje me kapacitetet e tyre. • Një fermer i madh në sektorin e qumështit ka raportuar se investimi në panelet diellore nuk është tërheqës për shkak të periudhës së gjatë të rikthimit të investimeve, e cila është afërsisht 10 vjet për një sistem me kapacitet 20-30 kW. • Ofruesit e inputeve, përfshirë ata që ofrojnë panele diellore dhe teknologji të tjera, nuk kanë mbikëqyrje në lidhje me cilësinë e produkteve të tyre dhe cilësinë e instalimeve. Po ashtu, nuk ka inspektime në terren ose kontrolle për të siguruar efikasitetin e inputeve të përdorura. • Në industrinë e përpunimit të qumështit, trajtimi i hirrës mbetet një sfidë e madhe, për shkak të kostos së lartë dhe menaxhimit të ndërlikuar të nevojshëm, për ta trajtuar atë në mënyrë efikase. Shumica e fabrikave të qumështit e derdhin atë në sistemin e ujërave të zeza. • Menaxhimi i plehut të lëngshëm dhe burimeve të ujit paraqesin sfida të mëdha, pasi disa fermerë përdorin të njëjtin pus për ujitje dhe nevoja shtëpiake, gjë që mund të rezultojë në ndotje të mundshme. • Qasja në treg dhe çështjet e eksportit janë sfida të rëndësishme, me mundësi aktualisht të kufizuara për eksportin e produkteve shtazore.
Perimet	<ul style="list-style-type: none"> • Fermerët vazhdojnë të mbjellin me fara të pa-certifikuara nga gjyshërit e tyre. • Shumica e fermerëve nuk janë në dijeni për mbetjet e pesticideve dhe periudhën e korrjes pas aplikimit të pesticideve. • Ujitja është e vështirë për t'u kontrolluar për shkak të mungesës së pajisjeve adekuate (sistemit inteligjent për ujitje), dhe harxhohet më shumë ujë sesa kërkojnë bimët. • Rrotacioni i kulturave përdoret rrallë, sepse disa zona nuk kanë sisteme të ujitjes dhe kanë toka më të dobëta. • Analizat e tokës nuk kryhen dhe plehërimi nuk bazohet në kërkesat e bimëve.

	<ul style="list-style-type: none"> • Në disa raste, fermerët kanë deklaruar se nuk janë të kënaqur me efektin e pesticideve, kështu që kanë rritur dozën e përdorimit. • Ka mungesë e skemave të ndryshme qeveritare për të mbështetur fermerët për bujqësi të qëndrueshme. • Fermerët janë të pakënaqur me shërbimet që marrin për rritjen e bimëve, pra ka mungesë të këshilltarëve profesionalë.
<p>Fruta të buta</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Bujqësia organike nuk funksionon sepse diferenca e çmimit ndërmjet mjedrës organike dhe asaj të zakonshme është e papërfillshme. E kemi provuar, por nuk ka funksionuar. • Fermerët ujin pa ndonjë rregull ose kontroll, kryesisht duke përdorur ujë nga puset. • Temperaturat e larta paraqesin rrezik të madh për kultivimin e mjedrave në Kosovë, pasi ato mund të çojnë në ulje të cilësisë së frutave, rendiment më të ultë dhe rritje të ndjeshmërisë ndaj insekteve dëmtuese dhe sëmundjeve. Kjo është një sfidë e madhe aktuale për fermerët, pasi ata duhet të gjejnë mënyra për të zbutur këtë rrezik dhe të përshtasin praktikat për mbrojtjen e prodhimit e tyre, në kushte klimatike gjithnjë e më të ngrohta. • Pengesa kryesore për përdorimin e praktikave të qëndrueshme për kultivimin e frutave të buta është aspekti financiar. Kostot e larta fillestare për teknologjitë e qëndrueshme dhe qasja e kufizuar në opsione të përballueshme financimi e bëjnë të vështirë që fermerët të investojnë, pavarësisht përfitimeve afatgjata. • Disa fermerë kanë përmendur vazhdimisht se pesticidet nuk u duken më efektive, duke i bërë ata të përdorin doza më të larta të pesticideve. • Vitet e fundit është bërë e vështirë sigurimi i plehrave organike për shkak të rënies së numrit të kafshëve, si rezultat i migrimit dhe lëvizjeve të popullsisë nga zonat rurale në ato urbane.
<p>Bimët Mjekësore Aromatike (BMA)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i fermerëve për të përdorur pajisje të veçanta për kontrollimin e barishteve të këqija në prodhimin organik (p.sh. kontrollimi i barishteve të këqija) është problem i madh sepse fermerët shpenzojnë shumë kohë për t'i hequr barishtet e këqija. • Ujitja është vështirë e kontrolluar për shkak të mungesës së pajisjeve adekuate (sistemit inteligjent për ujitje), dhe harxhohet më shumë ujë sesa kërkojnë bimët. • Ka mungesë të skemave të ndryshme qeveritare për të mbështetur fermerët për bujqësinë e qëndrueshme. • Nuk ka masa specifike të ofruara nga MBPZHR, për grante për BMA organike. • Çmimi është i shtrenjtë për certifikimin e produkteve organike. • Ka një diferencë të vogël të çmimit ndërmjet produkteve organike dhe atyre të zakonshme.

5.3. Mundësitë dhe fushat për intervenim

Ekzistojnë mundësi të shumta për të përmirësuar praktikat e qëndrueshme në sektorin e bujqësisë në Kosovë. **Rritja e mundësisë dhe cilësisë së trajnimeve teknike për fermerët është thelbësore** për të përmirësuar përdorimin dhe përvetësimin e praktikave të qëndrueshme. **Përmirësimi i funksionalitetit të shërbimeve këshilluese** dhe krijimi i zyrave të dedikuara për mbështetje të fermerëve në kuadër të komunave lokale mund të ofrojë asistencë të vazhdueshme. **Përshtatja e skemave të granteve me praktikat e qëndrueshme** mund të

përbëjë një hap tjetër të rëndësishëm drejt zbatimit të këtyre praktikave. Investimet në infrastrukturë për menaxhimin e mbeturinave mund të zvogëlojnë ndikimin në mjedis.

Për më tepër, **rritja e ndërgjegjësimit ndërmjet fermerëve për përfitimet nga praktikat e qëndrueshme** dhe përdorimin e duhur të pajisjeve mund të çojë në norma më të larta të përdorimit. Përveç kësaj, forcimi i lidhjes ndërmjet sektorit privat dhe akademisë, së bashku me mbështetjen e shtuar për aktivitete kërkimore për bujqësi të qëndrueshme dhe ekonominë qarkore, mund të nxisë inovacion dhe të përmirësojë efikasitetin e këtyre praktikave. Disa nga mundësitë kryesore dhe fushat për intervenim përshkruhen më në detaje, më poshtë.

Trajnime dhe mbështetje teknike e shtuar

Rritja e trajnimeve dhe mbështetjes teknike është një fushë thelbësore për intervenim për avancimin e bujqësisë së qëndrueshme. Për të adresuar këtë nevojë, është e domosdoshme të ofrohen trajnime të vazhdueshme, të specializuara dhe të përshtatura sipas kërkesave specifike të fermerëve, me fokus në praktikat e qëndrueshme. Ky trajnim duhet të dizajnohet për t'i pajisur fermerët me njohuritë dhe aftësitë më të fundit të nevojshme për zbatim efektiv. Për më tepër, krijimi i shërbimeve këshilluese²⁸ të posaçme dhe zyrove mbështetëse në kuadër të komunave lokale mund të ofrojë asistencë dhe udhëzime të vazhdueshme për fermerët, duke siguruar që ata të kenë qasje në burime dhe ekspertizën e nevojshme, për të përvetësuar dhe mbajtur praktikat e qëndrueshme.

Përfshirja e shërbimeve këshilluese private ose shërbimeve këshilluese në partneritet publik-privat mund ta forcojë më tej mbështetjen për fermerët. Këto shërbime mund të ofrojnë këshilla nga ekspertët mbi praktikat e qëndrueshme, të ndihmojnë në identifikimin e zgjidhjeve dhe teknologjive më efikase sipas rasteve specifike të fermerëve dhe të vlerësojnë kthimin e investimeve dhe përfitimet ekonomike të këtyre teknologjive. Duke këshilluar fermerët mbi nevojat e tyre specifike dhe duke ofruar udhëzime mbi alternativat më të mira të qëndrueshme, këto shërbime mund të luajnë rol kritik në promovimin e vendimmarrjes së informuar dhe optimizimin e përfitimeve nga investimet në bujqësinë e qëndrueshme.

Qasja në treg

Lehtësimi i qasjes në treg për produktet bujqësore të prodhuara në mënyrë të qëndrueshme do të kontribuonte më tej në kalimin drejt ekonomisë së gjelbër. Kërkesa për eksportimin e produkteve bujqësore, veçanërisht në tregun e BE-së, mund të nxisë ndryshime në praktikat bujqësore në Kosovë. Importuesit shpesh imponojnë kërkesa shtesë për produktet, që mund të çojnë në standarde bujqësore më të rrepta, duke përfshirë praktikat e qëndrueshme. Për shembull, fermerëve në Kosovë që kultivojnë BMA, u kërkohet respektimi i praktikave të qëndrueshme për shkak të standardit organik, ashtu siç i kërkon tregu i tyre i eksportit. Këta fermerë kanë një treg shumë specifik; megjithatë, pa këto kërkesa të tregut, ata nuk do t'i zbatonin ato praktika vullnetarisht²⁹. Kjo përfaqëson një zhvillim të orientuar nga tregu. Kjo

²⁸ Duke marrë parasysh ekspertizën aktuale në dispozicion të shërbimeve këshilluese publike dhe private, është thelbësore që fillimisht të trajnohen këshilltarët që të mund të ndajnë në mënyrë efikase njohuritë e tyre me fermerët. Megjithatë MBPZHR, certifikon këshilltarët, është thelbësore të ofrohet trajnim dhe certifikim i fokusuar për këshilltarët e rinj të specializuar në bujqësi të qëndrueshme, për të siguruar që ata të përcjellin njohuritë përkatëse dhe praktikat më të mira. Kjo nevojë u theksua, gjithashtu, nga shumica e fermerëve gjatë diskutimeve në grupe të fokusuar.

²⁹ Përveç kësaj, disa fermerë të frutave manore dhe perimeve zbatojnë standarde të tilla siç është Global GAP, në përgjigje të kërkesave të tregut për eksporte. Pikat grumbulluese nënshkruajnë kontrata me fermerë sepse janë të motivuar të zbatojnë standardet përkatëse si rezultat i kërkesës për importe.

qasje e orientuar nga tregu promovon në mënyrë efikase qëndrueshmërinë, pasi presioni për të përmbushur kërkesat e tregut inkurajon përdorimin e praktikave miqësore me mjedisin. Së fundi, zhvillimet e orientuara nga tregu janë të qëndrueshme, dhe tregu mund të luajë një rol të rëndësishëm në avancimin e praktikave bujqësore të qëndrueshme, pasi krijon kërkesën dhe presionin e nevojshëm për një ndryshim më të gjerë në praktikat aktuale të prodhimit.

Stimujt dhe mbështetja ekonomike

Stimujt dhe mbështetja ekonomike mund të jenë fusha kryesore për intervenim, për promovimin e bujqësisë së qëndrueshme. Për shembull, skemat e granteve mund të përshtaten posaçërisht për të inkurajuar dhe shpërblyer praktikat e qëndrueshme, duke siguruar që mbështetja financiare të përputhet me standardet mjedisore dhe prodhuese. Megjithatë, është shumë e rëndësishme të monitorohet dhe kontrollohet që këto investime të realizohen sipas standardeve të përcaktuara dhe të adresojnë nevojat e fermerëve. Kjo qasje e synuar mund t'i ndihmojë fermerët të përdorin zgjidhje efektive dhe afatgjata, që rrisin produktivitetin dhe promovojnë mbrojtjen e mjedisit.

Programet për njohuri, ndërgjegjësim dhe rrjetëzim bashkëpunues

Programet e njohurive dhe të ndërgjegjësimit, së bashku me rrjetet për bashkëpunim, mund të përbëjnë fusha të rëndësishme për intervenim, për avancimin e bujqësisë së qëndrueshme në Kosovë. Rritja ndërgjegjësimi tek fermerët për përfitimet e praktikave të qëndrueshme dhe përdorimin e duhur të pajisjeve është thelbësore për të inkurajuar një kulturë të qëndrueshmërisë. Mund të organizohen punëtori dhe sesione trajnimi të përshtatura, për t'i mbajtur fermerët të informuar mbi teknologjitë dhe metodat më të fundit të qëndrueshme, duke siguruar që fermerët dhe anëtarët e tjerë të zinxhirit të vlerës të kenë njohuritë për zbatimin e këtyre praktikave në mënyrë efikase. Për më tepër, shoqatat e fermerëve mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e praktikave të qëndrueshme, pasi ato përfaqësojnë një burim të besueshëm informacioni dhe këshillash për fermerët. Forcimi i shoqatave të fermerëve mund të lehtësojë ndarjen e praktikave më të mira dhe burimeve, duke krijuar një mjedis që mbështet këto lloje të teknologjisë. Shtimi i bujqësisë së qëndrueshme në kurrikulat shkollore do të rrisë gjithashtu ndërgjegjësimin dhe njohuritë e brezave të ardhshëm. Fondet e dedikuara nga MASHTI, për aktivitete kërkimore për bujqësinë e qëndrueshme, do të luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në zbatimin e praktikave më të mira dhe rekrutimin e hulumtuesve të rinj. Mundësitë kryesore dhe intervenimet sipas nën-sektorëve, përshkruhen në tabelën më poshtë.

SEKTORI	VËSHTRIMET KRYESORE
Bylmeti	<ul style="list-style-type: none"> • MBPZHR nuk ka pasur asnjë masë deri tani për edukimin e fermerëve. Në të ardhmen, MBPZHR duhet të zhvillojë masa specifike që synojnë të edukojnë fermerët në aspekte të veçanta, siç janë praktikat e qëndrueshme. • Të ndërtohen dhe të mbështeten fermat e qëndrueshme që mund të shërbejnë si modele dhe të inspirojnë fermerë të tjerë. Kjo qasje mund të krijojë gjithashtu mundësi për shkëmbim të njohurive dhe për të punuar së bashku për përmirësimin e metodave bujqësore. • Kërkesa në treg mund të sjellë praktika bujqësore të qëndrueshme, pasi tregu mund të përcaktojë metodën e kultivimit/prodhimit dhe standardet që duhen ndjekur. • Kultivimi i barit si ushqim për kafshë, siç është subvencionimi i mbjelljes

së jonxhës, mund të shihet si një formë e bujqësisë së qëndrueshme, pasi prodhohet më pak pleh.

- Investimi në objektet e ruajtjes së plehut, së bashku me pajisjet e nevojshme për menaxhimin dhe shpërndarjen e plehut, dhe kombinimi i këtij investimi me përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin dhe edukimin e fermerëve mbi kohën optimale të plehërimit, mund të rrisin ndjeshëm efikasitetin dhe qëndrueshmërinë mjedisore të përdorimit të plehut në bujqësi. Projekti i menaxhimit të plehut i zbatuar nga KAMP, financuar nga SDC, ka pasur efekt pozitiv pasi ka ndjekur këtë qasje.
- Grantet ndonjëherë kanë çuar në një mungesë motivimi ndërmjet fermerëve, siç e tregon tendenca e tyre për të investuar në pajisje të panevojshme dhe për të plotësuar dëshirat personale në vend që të fokusohen në fushat esenciale, që do të përmirësonin produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e fermave të tyre. Prandaj, MBPZHR, duhet të ndryshojë strukturën e skemave të granteve dhe madje edhe të subvencioneve dhe të përpiqet t'i lidhë ato me praktikën e qëndrueshme.
- Investimet në infrastrukturën e menaxhimit të mbeturinave, siç janë objektet për trajtimin e hirrës dhe nën-produkteve të tjera, mund të zvogëlojnë ndjeshëm ndikimin mjedisor; megjithatë, për shkak të kostos së lartë të trajtimit të hirrës, përdorimi i saj si ushqim për kafshët e reja paraqet një zgjidhje praktike, dhe promovimi i hirrës për konsum nga njerëzit mund të krijojë kërkesë të konsiderueshme në treg, duke pasur parasysh përfitimet e saj. Kjo konsiderohet si zgjidhja më e përballueshme në situatën aktuale.
- Promovimi i përdorimit të burimeve të energjisë së rinovueshme, siç janë panelet diellore për ndriçim dhe ngrohje, kërkon që fermerët të marrin trajnime të duhura mbi instalimin dhe mirëmbajtjen e këtyre sistemeve, ndërkohë që sigurohet cilësia e teknologjisë së ofruar.
- Fonde të konsiderueshme janë shpenzuar për grante nga MBPZHR, por nuk ka pasur asnjë koment ose vlerësim të ndikimit mbi efikasitetin e tyre. Një vlerësim i ndikimit është i nevojshëm për të siguruar që fondet të ridrejtohen në investime që prodhojnë rezultate të prekshme dhe mbështesin objektivat mjedisore.

Perimet

- Të rritet njohuria mbi bujqësinë e qëndrueshme si koncept.
- Të trajnohen fermerët për mbetjet e pesticideve dhe periudhën e vjeljes pas aplikimit të pesticideve.
- Të promovohet përdorimi i teknologjive të reja dhe varieteteve të specave (rezistente ndaj insekteve dëmtuese, thatësirës etj.) dhe ndryshimeve klimatike.
- Të rritet ndërgjegjësimi për shëndetin e tokës dhe rotacionin e kulturave. Të rritet ndërgjegjësimi për aspektet mjedisore, pasi shumica e fermerëve mendojnë vetëm për prodhim.
- Të pakënaqur me subvencionet aktuale, fermerët kërkojnë që subvencionet të paguhen në bazë të rendimentit dhe cilësisë.
- Të nxiten praktikën e qëndrueshme përmes stimujve financiarë, siç janë subvencionet: p.sh., lënia e 20% të tokës të papunuar për të mbështetur biodiversitetin.
- Të forcohet kuadri ligjor përmes certifikimit, duke nënkuptuar se kur kërkohet certifikimi, kuadri ligjor mund të zbatohet dhe mbështetet në mënyrë efektive përmes skemave të certifikimit, në përputhje me rregullat dhe standardet e përcaktuara.

Fruta të buta

- Është e nevojshme rritja e ndërgjegjësimit dhe trajnimeve mbi kohën dhe metodat e duhura të plehërimit dhe praktikat e tjera të qëndrueshme.
- Të promovohet përdorimi i plehrave organike dhe metodave të bujqësisë së qëndrueshme.
- Një fushë kyçe e intervenimit për kultivimin e mjedrës është investimi në rrjetat kundër breshërit dhe/ose rrjetat për hije. Këto masa ndihmojnë në uljen e temperaturave deri në 30%, gjë që mund të përmirësojë ndjeshëm cilësinë dhe rendimentin e frutave. Sistemi i ujitjes digjital mund të jetë e prioritet i dytë për intervenim. Për përdorim në shkallë të këtyre intervenimeve, të paktën 70% e kostos duhet të mbulohet nga grantet, me 30% të mbetura të financohet nga fermerët.
- Fermerët e mëdhenj në fakt janë më të interesuar të investojnë në burime alternative të energjisë se sa fermerët e vegjël. Përveç mbështetjes së qeverisë, një nga shkaqet kryesore është rritja e fundit e çmimit të energjisë elektrike.
- Krijimi i tregjeve për fermerët që kërkojnë një grup të caktuar të praktikave dhe standardeve mund të mbështesë adoptimin më të shpejtë dhe më të qëndrueshëm të praktikave të bujqësisë së qëndrueshme. Pikat grumbulluese dhe shoqatat e fermerëve që lehtësojnë shitjen e produkteve të fermerëve mund të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.

Bimët Mjekësore Aromatike (BMA)

- Të rritet njohuria mbi bujqësinë e qëndrueshme si koncept.
- Të promovohet përdorimi i teknologjive të reja dhe varieteteve të BMA (rezistente ndaj insekteve dëmtuese, thatësirës etj.) dhe ndryshimeve klimatike.
- Praktikrat në bujqësinë e qëndrueshme të kushtëzohen nga subvencionet (pagesat direkte).
- Meqenëse konsumatorët nuk kanë njohuri për produktet organike, ku shumica e tyre shiten jashtë vendit, është e nevojshme të rritet ndërgjegjësimi i konsumatorëve për produktet organike.
- Aplikimet për grante në të ardhmen duhet të paraqiten nga grupe fermerësh, duke u lejuar atyre të aplikojnë për pajisje që mbështesin përdorimin e teknologjive të reja dhe mundësojnë përdorim të përbashkët.

Mundësitë përmes programit IPARD

Programi IPARD III, mund të luajë rol kyç në promovimin e inovacionit, në sektorin e bujqësisë në Kosovë, veçanërisht përmes mundësive që lidhen me ekonominë qarkore dhe praktikrat e qëndrueshme. Duke përdorur rrjetet e inovacionit që lidhin sektorin privat, fermerët dhe akademinë, programi mund të mbështesë zhvillimin e zgjidhjeve bujqësore qarkore dhe të qëndrueshme. Këto bashkëpunime mund të çojnë në inovacione për menaxhimin e mbeturinave, përdorimin e energjisë së rinovueshme, ruajtjen e ujit dhe praktikrat për prodhim të qëndrueshëm. Për shembull, mbështetja e projekteve që zhvillojnë dhe/ose zbatojnë teknologjitë e ujitjes që kursejnë ujë, siç është sistemi i ujitjes pikë-pikë. Financimi mund të përdoret për të testuar këto sisteme në ferma, duke ofruar trajnime teknike për fermerët lidhur me instalimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Kjo do të ndihmojë në optimizimin e përdorimit të ujit, reduktimin e mbeturinave dhe përmirësimin e rendimenteve të kulturave, duke adresuar njëkohësisht shqetësimet mjedisore që lidhen me mungesën e ujit.

Një mundësi tjetër është mbështetja e aktiviteteve kërkimore dhe zhvillimit të teknologjive bujqësore precize, siç janë sistemet inteligjente të ujitjes, që optimizojnë përdorimin e ujit dhe reduktojnë mbeturinat, duke promovuar kështu qëndrueshmërinë. Shërbimet këshilluese mund të luajnë rol të rëndësishëm për t'u siguruar fermerëve njohuritë e nevojshme, për të përdorur këto teknologji të reja në mënyrë efikase.

Për më tepër, Programi IPARD III, mund të financojë nisma kërkimore bashkëpunuese, ndërmjet universiteteve, fermave dhe bizneseve bujqësore për të zhvilluar dhe zbatuar mundësitë e përmendura më lart dhe praktikatat e tjera që lidhen me bujqësinë e qëndrueshme. Krijimi i nismave drejt aktiviteteve kërkimore, që mund të zbatohen në kontekstin specifik të Kosovës, dhe forcimi i shkëmbimit të njohurive ndërmjet akademisë, prodhuesve dhe akterëve të tjerë relevantë mund të nxisë më tej zhvillimet teknologjike. Duke e harmonizuar mbështetjen e IPARD me fushat kryesore për intervenime në Kosovë, siç janë trajnimet teknike, qasja në treg dhe investimet e fokusuara në qëndrueshmëri, programi mund të nxisë inovacion, duke e bërë sektorin e bujqësisë më të qëndrueshëm dhe konkurrues.

6. Mundësitë e financimit dhe mekanizmat financiarë

Qasja në financa për bujqësinë e qëndrueshme përfshin opsione të ndryshme të financimit të gjelbër si nga sektori publik ashtu edhe nga ai privat. Financimi nga sektori publik përbëhet kryesisht nga grante dhe subvencione të ofruara nga MBPZHR, që kanë për qëllim, pjesërisht promovimin e praktikave të bujqësisë miqësore me mjedisin dhe pjesërisht mbështetje për kalimin në bujqësi të qëndrueshme. Në sektorin privat, burimet e financimit përfshijnë kredi nga banka private dhe institucione mikro-financiare, disa lloje të granteve nga organizatat donatore, agjencitë zhvillimore multilaterale, dhe kryesisht projekte të vogla të financuara nga OJQ-të.

Këta mekanizma financiarë ofrojnë një lloj mbështetjeje për fermerët dhe agro-bizneset, duke u mundësuar atyre të përdorin praktika të qëndrueshme, të përmirësojnë produktivitetin dhe të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit.

6.1. Burimet e financimit nga sektori publik

MBPZHR, është ofruesi kryesor i financimit në sektorin e bujqësisë në Kosovë. MBPZHR, ofron mbështetje përmes dy programeve kryesore: programi i pagesave direkte dhe programi i granteve (skema e investimeve).

Pagesat direkte (PD)

Programi për PD është njëri nga dy programet kryesore të mbështetjes së politikave të MBPZHR-së. Në përpjekje për të mbështetur fermerët e Kosovës në rritjen e të ardhurave, zgjerimin e sipërfaqeve të fermave dhe kultivimin e produkteve me cilësi dhe sasi më të lartë, MBPZHR, ka zbatuar programin e PD-së që nga viti 2009 (Bajrami & Ostapchuk, 2019). Objektivat kryesore të programit përfshijnë: rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimit bujqësor primar, rritjen e të ardhurave të fermave, rritjen e rendimenteve, reduktimin e importeve, përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe zbatimin e standardeve të sigurisë ushqimore, uljen e kostove të prodhimit, zgjerimin e kapaciteteve përpunuese dhe intensifikimin e ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore. Për të arritur këto objektiva, programi zbatohet përmes pagesave direkte të ndryshme që targetojnë sektorët kryesorë të bujqësisë në vend, duke përfshirë: drithërat, bagëtitë, hortikulturën, frutat, bletarinë dhe peshkimin.

Të gjitha pagesat lidhen me sipërfaqen e kultivuar, numrin e krerëve të bagëtive, ose sasinë dhe/ose cilësinë e dorëzuar në njësitë përpunuese ose në tregjet formale (Bajrami, 2016;

Bajrami & Ostapchuk, 2019). Për shembull, në vitin 2023, programi ka përfshirë në total 28 masa, me buxhet të planifikuar mbi 40 milionë euro.

Sa i përket mbështetjes së bujqësisë së qëndrueshme, programi përmes PD, përfshin vetëm një masë, që mund të lidhet drejtpërdrejt me të—masa e PD-së për bujqësinë organike, e cila mbështet kultivimin organik të kulturave. Kjo masë përshkruhet më poshtë.

Masa e PD për bujqësinë organike

Sipas programit për PD 2023, Kosova ka potencial të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë organike, si rezultat i praktikave tradicionale bujqësore, veçanërisht në zonat e thella rurale, dhe kërkesës së lartë për këto produkte në tregjet e BE-së. Arsye të tjera për mbështetje të këtij nën-sektori, përfshijnë mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e kushteve të mira të tokës. Qëllimi i kësaj mase të pagesës direkte është rritja e të ardhurave të fermerëve, sigurimi i mirëmbajtjes së vazhdueshme të zonave të prodhimit organik dhe përmirësimi i konkurrueshmërisë. Objektivat specifike përfshijnë zgjerimin e sipërfaqeve të prodhimit organik, përmirësimin e cilësisë së prodhimit, uljen e kostove të prodhimit dhe rritjen e eksporteve të produkteve organike.

Fermerët duhet të dedikojnë të paktën 0.10 hektarë për prodhimin organik ose të jenë në fazën e shndërrimit dhe të ofrojnë prova ose certifikatë të statusit organik nga një organ certifikues i akredituar nga BE. Subvencioni ofrohet për hektar: 50 € për hektar për sipërfaqet në fazën e shndërrimit dhe 100 € për hektar për sipërfaqet e certifikuara për prodhimin organik, përveç subvencionit bazë për disa kultura, si për shembull, 150 € për hektar për grurë, 500 € për hektar për perimet në fushë të hapur, dhe 450 € për hektar për bimë mjekësore dhe aromatike, si dhe për bimët e mjaltit.

Sipas Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028, me mbështetje publike për bujqësinë organike që zbatohet nga viti 2016, janë certifikuar 480 hektarë bimë mjekësore dhe aromatike në sistemin e bujqësisë organike, me gjithsej 35 prodhues, dhe janë 522.47 hektarë kungulleshka të kultivuara për prodhimin e vajit organik dhe 34.07 hektarë arra organike.

Një masë tjetër që mund të lidhet pjesërisht me prodhimin e qëndrueshëm është një tjetër skemë e pagesave direkte që mbështet kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike dhe bimët e mjaltit. Poashtu, kjo masë përshkruhet më poshtë.

Masa e PD për Bimët Mjekësore dhe Aromatike (BMA) dhe bimët e mjaltit

Skema e mbështetjes për pagesat direkte për BMA dhe bimët e mjaltit në Kosovë synon të zgjasë sipërfaqet e kultivimit për këto bimë, të rrisë eksportet në vendet e BE-së dhe të ruajë burimet natyrore të vendit. Sektori i BMA-së ka pasur trend pozitiv të zhvillimit me rritjen e eksporteve në BE. Ky sektor është gjithashtu i rëndësishëm për industrinë agro-përpunuese dhe bletarinë, pasi shumë prej këtyre bimëve shërbejnë si burime për mjaltë (bimët e mjaltit). Aktualisht, rreth 500 hektarë BMA dhe bimët e mjaltit kultivohen në Kosovë, me rreth 45 lloje të ndryshme të BMA-ve.

Mbështetja përmes pagesave direkte synon ruajtjen e sipërfaqeve ekzistuese të kultivuara dhe zgjerimin e zonave të reja. Qëllimi i kësaj politike është rritja e të ardhurave për fermerët, mirëmbajtja e vazhdueshme e sipërfaqeve të mbjella dhe të përmirësimi i konkurrueshmërisë. Objektivat specifike përfshijnë zgjerimin e sipërfaqeve për BMA dhe bimët e mjaltit, rritjen e rendimenteve, përmirësimin e cilësisë së prodhimit, uljen e kostove të prodhimit, rritjen e eksporteve të BMA dhe rritjen e prodhimit të mjaltit. Fermerët duhet të kultivojnë të paktën 0.10 hektarë BMA ose bimët e mjaltit, për t'u kualifikuar për subvencionim, i cili ofrohet në një

shkallë prej 450 € për hektar. Në total, mbështeten 21 lloje kryesore të BMA-ve dhe bimët e mjaltit që kultivohen në Kosovë, duke përfshirë kamomil, hithra, rigon, mentë, sherbelë, malvaceae, livando dhe të tjera.

Kjo masë e pagesës direkte që mbështet kultivimin e BMA-ve dhe bimët e mjaltit mund të lidhet me bujqësinë e qëndrueshme dhe të ketë efekte pozitive në mjedis. Këto bimë shpesh kërkojnë më pak inpute kimike, përmirësojnë biodiversitetin dhe kontribuojnë në shëndetin e tokës. Për më tepër, ato mund të mbështesin popullatat e pjalmuesve, të përmirësojnë eko-sistemin dhe të promovojnë praktikën e menaxhimit të qëndrueshëm të tokës, duke kontribuar kështu në qëndrueshmërinë e përgjithshme mjedisore.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se, përveç masës që mbështet bujqësinë organike, pagesat direkte nuk lidhen me asnjë kusht mjedisor, dhe aktualisht nuk ka masa agro-mjedisore të zbatuara, ose ndonjë masë të PD të kushtëzuara mbi praktikën bujqësore miqësore me mjedisin ose praktikën e qëndrueshme në Kosovë.

Skemat e granteve për investime

Programi i granteve ka mbështetur investimet në sektorin primar, por gjithashtu edhe industrinë përpunuese, si dhe diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e bizneseve. Përgatitja dhe zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal – qasja LEADER – gjithashtu është mbështetur. Në vitin 2023, buxheti i planifikuar për programin e granteve arriti pothuajse 25 milionë euro³⁰.

Programi i granteve të MBPZHR-së është strukturuar rreth disa masave kryesore, me mbështetje që ndryshon në varësi të aktivitetit ose nën-sektorit specifik. Sa i përket bujqësisë së qëndrueshme, skema e granteve të MBPZHR-së, përfshin masat e mëposhtme:

- **Masa 1:** Ofron pikë shtesë për instalimet e paneleve diellore dhe kërkon gropa septike të detyrueshme. Mbështet gjithashtu investimet në ujitje të avancuar dhe sisteme kundër breshërit, nëse kërkohet nga fermeri³¹.
- **Masa 3:** Instalimi i paneleve diellore është i detyrueshëm, ndërsa rekomandohen investime në impiantet për trajtim të ujit. Pikë shtesë jepen për investimet e qëndrueshme të rekomanduara³².
- **Masa 7:** Mbështet investimet në objekte me shkallë të vogël, siç janë impiantet e trajtimit dhe panelet diellore, të cilat janë të lidhura me aktivitetet bujqësore dhe përpunimin në shkallë të vogël³³.

Për shembull, panelet diellore kanë qenë një praktikë e zakonshme që është mbështetur përmes skemës së granteve. Kapacitetet e mesme të instaluara të energjisë së rinovueshme (panelet diellore) për njësi ferme/biznes bujqësor sillen nga 3 deri në 4 kW³⁴. Vetëm gjatë periudhës 2014-2019, janë investuar mbi 6.6 milion euro në panelet diellore, duke arritur një

³⁰ Sipas një interviste me informatorët kryesorë (IIK), me një zyrtar nga MBPZHR, Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (PBZHR) 2023–2027, aktualisht nuk përfshin skemat e granteve për bujqësi të qëndrueshme. Megjithatë, MBPZHR është duke negociuar me GIZ-in, për të krijuar një masë mbështetëse në vlerë 5 milionë euro për vitin 2025, e fokusuar në bujqësinë e qëndrueshme, e cila do të përfshijë dy masa: agro-mjedisin dhe bujqësinë organike.

³¹ https://azhb-rks.net/repository/docs/2023_11_08_034631_Udhezuesi_per_aplikues_Masa_1-Investimet_ne_astete_fizike_te_ekonomive_familjare.pdf


³² https://azhb-rks.net/repository/docs/2023_10_30_075928_Udhezuesi_per_Aplikues_Masa_3_-_Investimet_ne_astete_fizike_ne_perpunimin_dhe_tregtimin_e_produkteve_bujqesore.pdf

³³ https://azhb-rks.net/repository/docs/2023_10_30_075811_Udhezuesi_per_Aplikues_Masa_7_Diversifikimi_i_fermeve_dhe_zhvillimi_i_biznesit_.pdf

³⁴ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_20222028_FINAL_ENG_Web_Noprint_final_PDF.pdf

kapacitet total prej më shumë se 3,690 kW. Figura në vijim paraqet numrin e njësive përfituese – fermat/agro-biznese, kapacitetin e instaluar për vit dhe kapacitetin mesatar të instaluar për njësi. Siç paraqitet në figurën më poshtë, ka një ulje të qëndrueshme nga viti në vit, për kapacitetin mesatar të instaluar për njësi gjatë kësaj periudhe.

Figura 1: Numri dhe kapaciteti i paneleve diellore në fermat e mbështetura, 2014-2019³⁵



6.2. Burimet e financimit nga sektori privat

Sektori privat ofron opsione të përshtatshme për financim të gjelbër, kryesisht përmes produkteve bankare siç janë kreditë dhe skemat e garantimit të kredive që lidhen me mbështetje për nisma të qëndrueshme, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Produktet bankare

Financimi nga sektori privat për nisma të qëndrueshme në sektorin e bujqësisë në Kosovë ofrohet kryesisht përmes bankave dhe institucioneve mikro-financiare. Ndërsa bankat komerciale ofrojnë kredi bujqësore (agro-kredi³⁶) si pjesë e ofertave të tyre standarde të produkteve, **nuk ka produkte të specializuara të kredive të dizajnuara posaçërisht për praktikën e bujqësisë së qëndrueshme.** Disa banka komerciale ofrojnë kredi ekologjike, por këto zakonisht synojnë rinovimin e apartamenteve apo shtëpive dhe jo nisma bujqësore. Në anën tjetër, kreditë emergjente zakonisht financohen nga institucionet mikro-financiare.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është një entitet i pavarur që përmirëson qasjen në financim për NVM, përmes ofrimit të garancive kreditore për institucionet financiare, me qëllim mbështetjen e ndërmarrësinë, rritjen e prodhimit vendor, krijimin e vendeve të punës dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik në përgjithësi. Ata kanë disa dritare të garancisë kreditore. Dritarja e Gjelbër Rimëkëmbjes dhe Mundësive (ang. **The Green Recovery and Opportunity Window - GROW**) synon të ndihmojë bizneset të investojnë në energji të rinovueshme dhe energji

³⁵ ndërtuar nga autorët me të dhënat e marra nga https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_20222028_FINAL_ENG_Web_Noprint_final_PDF.pdf

³⁶ Një tjetër mundësi financimi është përmes kredit kartelave që ofrohet nga një numër i bankave komerciale për të blerë inpute.

efiçiente. Megjithatë, aplikimi i saj në bujqësi ka qenë minimal, pa raste të raportuara të përdorimit të këtyre fondeve.

Përveç kësaj, financimi i zinxhirëve të vlerës është aplikuar përmes disa bankave komerciale, të cilat ofrojnë financim të lidhur me qendrat grumbulluese dhe përpunuesit. Kjo ka çuar në investime të suksesshme në kopshte të reja me mjedra me fidane të certifikuara dhe sistem të ujitjes pikë-pikë, si dhe skema për blerjen e mëshqerrave të destinuara për fermat e bylmetit. Megjithatë, pavarësisht këtyre përpjekjeve, mbetet një hendek i konsiderueshëm në produktet financiare të përshtatura që mbështesin në mënyrë specifike bujqësinë e qëndrueshme.

6.3. Burime të tjera të financimit

Një burim tjetër i rëndësishëm për financimin e gjelbër në bujqësi vjen nga organizatat ndërkombëtare, agjencitë donatore, bankat zhvillimore multilaterale, si dhe nga OJQ-të, të cilat ofrojnë opsione të ndryshme të mbështetjes financiare për të promovuar praktikën e qëndrueshme në sektorin e bujqësisë.

Bankat zhvillimore multilaterale

Grupi i Bankës Botërore po promovon në mënyrë aktive bujqësinë e qëndrueshme në Kosovë duke ofruar financim, këshillim dhe mbështetje për institucionet financiare dhe publike. Për shembull, ka nisma nga Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), një organizatë anëtare e Grupit të Bankës Botërore, që lidhen me bujqësinë e qëndrueshme. Në këtë drejtim, gjatë viteve të fundit, qasja e IFC ka qenë e fokusuar në dy fusha kryesore: ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e produkteve. Ata kanë trajnuar stafin e institucioneve financiare për të kuptuar dhe menaxhuar më mirë rreziqet në fushën e bujqësisë dhe kanë bashkëpunuar me banka për të dizajnuar produkte financiare të përshtatura për nevojat e klientëve bujqësorë. Këto produkte përfshijnë financimin e makinerive bujqësore, sistemeve kundër breshërit, sistemit të ujitjes pikë-pikë, plehërimit, lopëve qumështore dhe paneleve diellore, shpesh të lidhura me sigurimin bujqësor për të ndihmuar bankat të menaxhojnë rreziqet në mënyrë më efikase.

Përveç kësaj, IFC, ka prezantuar në treg një sistem për sigurime bujqësore, që synon zbutjen e rreziqeve dhe ofrimin e ndihmës për vendimmarrje më të mirë për fermerët. Ata gjithashtu angazhohen në financimin e zinxhirëve të vlerës, duke punuar me akterë të ndryshëm — me furnizuesit e inputeve, fermerët dhe përpunuesit — për të forcuar të gjithë zinxhirin e vlerës bujqësore. Projektet aktuale, si Projekti i Financave të Qëndrueshme të BE-së dhe Projekti kulturave dhe arkëtimeve të depove, theksojnë më tej rolin e IFC-së, në avancimin e praktikave bujqësore të qëndrueshme në Kosovë.

Po ashtu, **Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) vepron në Kosovë me fokus në promovimin e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm përmes investimeve në sektorë të ndryshëm.** Produktet e saj kryesore përfshijnë financimin në infrastrukturë, energji efiçiente dhe rritjen e sektorit privat. Nismat e fundit të financimit të gjelbër përfshijnë mbështetje për projekte të energji efiçiente, siç janë investimet në energji efiçiente dhe energji të rinovueshme nga familjet dhe bizneset lokale, për shembull, duke ndihmuar familjet të kalojnë nga stufat tradicionale me dru në sisteme më të qëndrueshme për ngrohje, si dhe financim për izolimin e shtëpive dhe dritareve efiçiente. Në bujqësi, disa nisma përfshijnë financim në një fabrikë mishi dhe një prodhues të biskotave për të reduktuar konsumimin e energjisë dhe kostot operative. Një shembull tjetër është financimi operacioni i shitjes me pakicë të agrobiznesit, me përmirësime të qëndrueshmërisë dhe ndërtimin e një qendre logjistike moderne, të certifikuar sa i përket qëndrueshmërisë. Gjithashtu, BERZH, ka lehtësuar financimin e qëndrueshëm duke

ofruar kredi për bankat vendore, të cilat më pas mbështesin investimet në teknologjitë e energjisë eficiente dhe zgjidhjet e energjisë së rinovueshme për aktivitetet bujqësore.

Po ashtu, Banka për Zhvillim (KfW) është aktive në Kosovë me projekte siç është financimi i një ferme diellore për të përmirësuar kapacitetin e energjisë së rinovueshme dhe mbështetje për projektin e ngrohjes qendrore në Prishtinë, për të përmirësuar eficiencën e energjisë dhe për të reduktuar emetimet.

Organizatave donatore

Shumica e organizatave kryesore donatore kanë qenë të angazhuara në nisma të ndryshme në vitet e fundit, duke mbështetur drejtpërdrejt ose tërthorazi përpjekjet për bujqësi të qëndrueshme. Disa nga donatorët kryesorë përfshijnë: Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Caritas, Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Agjencinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA), Fondin për Zhvillim të Komunitetit (CDF), Danida, dhe Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë (BE).

Për shembull, aktiviteti më i fundit i USAID-it – Projekti USAID Kosova Adapt, i financuar nga USAID dhe i zbatuar nga Tetra Tech, është program pesëvjeçar me buxhet prej 13 milion dollarë, i dizajnuar për të rritur qëndrueshmërinë ndaj klimës në komunitetet dhe bizneset e Kosovës. Nisma synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe kërkesën e sektorit publik dhe privat për nisma të mençura klimatike, duke përmirësuar njëkohësisht kapacitetin e Kosovës, për të miratuar dhe zbatuar politika dhe teknologji mbështetëse. Duke u fokusuar në identifikimin e pengesave dhe mundësive, rritjen e ndërgjegjësimit dhe mundësimin e palëve të interesuara për të prezantuar nisma të mençura klimatike, programi synon të krijojë një ambient më të qëndrueshëm dhe të promovojë qëndrueshmërinë ekonomike për qytetarët e Kosovës. **Nismat e fundit përfshijnë skema të granteve për OJQ, fondacione private, universitete, kompani dhe shoqata biznesi për të zhvilluar nisma që promovojnë adaptimin e masave për përshtatjen dhe zbutjen e efekteve të klimës, me aktivitete të granteve që sillen nga 20,000 deri në 60,000 euro, për një periudhë prej 12 deri në 24 muaj.**

Një shembull tjetër është Programi i Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë (IWRM-K), i financuar nga SDC dhe zbatohet nga Skat Consulting, **i cili ka mbështetur fermerët individualë me skema konkurruese grante të orientuara për përmirësimin e menaxhimit të burimeve ujore të qëndrueshme.** Këto nisma kanë fokus fermerët e qumështit duke mbështetur ndërtimin e magazinave për pleh organik dhe duke ofruar makineri të nevojshme për shpërndarjen e plehut të lëngshëm dhe të ngurtë në fusha. Një skemë tjetër e grantit ka në fokus prodhuesit e mjedrës dhe mollës, duke ofruar grante për të mbështetur praktikatat moderne të bujqësisë, të dizajnuara për të reduktuar ndikimet mjedisore dhe për të përmirësuar cilësinë e prodhimit. Mbështetja përfshin këshilla të përshtatura, grante dhe pajisje inovative si stacionet uMethos për ujitje precize, për të reduktuar përdorimin e ujit dhe kostot, ndërsa përmirëson efikasitetin dhe rendimentin. Po ashtu, bazuar në analizat e tokës, janë organizuar takime informuese, për të ofruar rekomandime dhe orare për plehërim, duke adresuar ndotjen e tokës dhe për përmirësimin e shëndetit të kulturave.

OJQ-të dhe burimet tjera

Në Kosovë, OJQ-të luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetje të bujqësisë së qëndrueshme dhe zhvillimit të qëndrueshëm në përgjithësi, kryesisht përmes avokimit për zhvillimin e politikave dhe mbështetjes institucionale. Për shembull, OJQ Fondacioni Ballkani i Gjelbër (BGF), përqendrohet në avokim për energjinë dhe de-karbonizimin, si dhe angazhon të rinjtë me

ide inovative që të promovojnë përpjekjet për de-karbonizim. OJQ-të gjithashtu, zbatojnë projekte në shkallë të vogël, të tilla si ofrimi i sistemeve të ujitjes pikë-pikë, serave të vogla dhe trajnimeve për ndërtimin e kapaciteteve për fermerët.

Megjithatë, pavarësisht këtyre përpjekjeve, siç është identifikuar në intervistat me informatorët kryesorë dhe grupet e fokusuara, Kosova përballlet me sfida të konsiderueshme në zbatimin e strategjive³⁷ dhe planeve kombëtare të miratuara për zhvillimin e qëndrueshëm dhe de-karbonizimin. Një pengesë kryesore është se njerëzit me arsim të lartë zakonisht punojnë për institucione që propozojnë, por nuk zbatojnë politika, duke lënë një boshllëk në zbatimin e këtyre strategjive. Fushat kryesore për intervenim të identifikuar nga shoqëria civile përfshijnë: promovimin e përdorimit të energjisë eficiente, izolimin, energjinë e rinovueshme (siç është energjia diellore dhe e erës), si dhe edukimin formal dhe joformal mbi praktikat e qëndrueshme.

6.4. Mundësitë alternative të financimit në kuadër të programit IPARD III

Programi IPARD i BE-së, ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetje të sektorit të bujqësisë për vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Turqinë, duke ofruar ndihmë financiare për modernizimin e sektorit të bujqësisë dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë. Shumica e vendeve që përfitojnë nga programi IPARD, janë ende në proces të zbatimit të programit IPARD II. Megjithatë, këto vende gjithashtu kanë miratuar programin IPARD III, për periudhën 2021-2027.

Masat më të zakonshme të shfrytëzuara në të gjitha vendet janë: M1 (Investime në asete fizike të njësive bujqësore), M3 (Investime në asete fizike të lidhura me përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe peshkimit) dhe M7 (Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve), megjithëse M7 nuk zbatohet në Mal të Zi. Masa M4 (Agro-mjedisi, klima dhe bujqësia organike) është e pranishme vetëm në Turqi, megjithatë me financim modest³⁸. Sa i përket bujqësisë së qëndrueshme dhe projekteve të përgjithshme të ekonomisë së gjelbër, nuk ka pasur masa specifike që mbështesin drejtpërdrejt këto investime. Megjithatë, investimet janë realizuar duke përdorur masat e zakonshme të përmendura më sipër. Tabela më poshtë pasqyron investimet kryesore në këtë kontekst, me shembuj nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

Vendi	Shembuj të investimeve në ekonominë e gjelbër në kuadër të programit të mëparshëm IPARD
Shqipëria ³⁹	Gjatë periudhës 2014-2020 në kuadër të programit IPARD II, janë zbatuar komponentë të vegjël të ekonomisë së gjelbër, duke përfshirë panelet fotovoltaike, sistemet e për trajtim të kafshëve dhe investimet në energjinë eficiente.
Maqedonia e Veriut	Masat ekzistuese në kuadër të programit IPARD të mëparshëm 2014-2020, për investime në asete fizike dhe diversifikim e nismave të gjelbra të mbështetura, siç janë makineritë eficiente, menaxhimi më i mirë i plehut, përdorimi më eficient i ujit, energjia e rinovueshme, dhe përmirësimi i efikasitetit të burimeve në nivel ferme. Nuk ka pasur masa për bujqësinë organike gjatë

³⁷ Strategjia për de-karbonizimin e sektorit të energjisë. Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën. Kontributi Kombëtar i Përcaktuar (NDC).

³⁸ <https://seerural.org/wp-content/uploads/2024/03/agricultural-policy-developments-in-the-eu-pre-accession-countries-final-report.pdf>

³⁹ <https://seerural.org/wp-content/uploads/2024/03/agricultural-policy-developments-in-the-eu-pre-accession-countries-final-report.pdf>

<https://ipard.gov.mk/wp-content/uploads/2024/07/AIR-2023.pdf>

<https://uap.gov.rs/wp-content/uploads/2024/02/Annual-Implementation-Report-on-IPARD-II-Programme-for-2022.pdf>

	kësaj periudhe.
Serbia	Masa 1 mbështetë ruajtjen dhe trajtimin e plehut, Masa 3 promovon energjinë e rinovueshme, dhe Masa 7 mundëson blerjen e pajisjeve për prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme.

Me programin IPARD III, BE-ja synon t’u ofrojë vendeve përfituese mbështetje financiare dhe teknike konkrete për të arritur zhvillim të balancuar të vendit duke rritur standardet sociale, mjedisore dhe ekonomike në zonat rurale. Programi ka për qëllim:

- Të përmirësojë konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sektorit agro-ushqimor duke ndërtuar një sektor bujqësor konkurrues në treg.
- Të promovojë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.
- Të forcojë qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike⁴⁰.

Masat e reja në kuadër të programit IPARD III (2021-2027), për vendet para-anëtarësimin përfshijnë: agro-mjedisin, klimën dhe bujqësinë organike (M4), zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal përmes qasjes LEADER (M5), investime në infrastrukturën publike rurale (M6), përmirësimin e aftësive dhe kompetencave (M8), shërbime këshilluese (M10), dhe mbrojtjen e pyjeve (M11).

Në kuadër të masës “Agro-mjedisi, klima dhe bujqësia organike”, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6), ofrojnë opsione të ndryshme për investime agro-mjedisore, me **bujqësinë organike** si më të zakonshmen.⁴¹ Masat specifike në kuadër të M4 janë të renditura në tabelën e mëposhtme.

	Shqipëria	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia
IPARD III Nën- masat M4 <small>42</small>	Bujqësia organike (vetëm për F&P, BMA, dhe vreshta) Shndërrimi i racave lokale të ripërtpësve të vegjël: dele dhe dhi	Përdorimi i qëndrueshëm i kullotave malore Prodhimi organik Burimet gjenetike në bujqësi	Mbulesa e gjelbër e kulturave të përhershme Rotacioni i kulturave të perimeve Bujqësia organike	Rotacioni i kulturave në tokat bujqësore Kontrolli i barishteve të këqija në plantacionet shumëvjeçare Ngritja dhe mirëmbajtja e shiritave pjalmues Menaxhimi i qëndrueshëm i livadheve dhe kullotave

Në përgjithësi, programi IPARD III, ofron disa mundësi për avancimin e bujqësisë së qëndrueshme. Programi krijon potencial për të prezantuar qasje më të gjelbra, veçanërisht përmes masave të reja të fokusuara në agro-mjedisi, bujqësinë organike, pylltari, përshtatje dhe

⁴⁰ https://agriculture.ec.europa.eu/international/international-cooperation/enlargement/pre-accession-assistance/overview_en

⁴¹ Zhang, Fang; Zorya, Sergiy; Zivkov, Goran. 2024. Greening Agriculture in the Western Balkans. Washington, DC: World Bank. <http://hdl.handle.net/10986/41843>

⁴² “Zhang, Fang; Zorya, Sergiy; Zivkov, Goran. 2024. Greening Agriculture in the Western Balkans. Washington, DC: World Bank. <http://hdl.handle.net/10986/41843>

zbutje të ndryshimeve klimatike, si dhe shërbimeve këshilluese. Zbatimi i nën-masave M4, mund të luajë një rol kyç në përmirësimin e ndërgjegjësimit mjedisor në bujqësi, duke forcuar kapacitetin e institucioneve për të aplikuar masat agro-mjedisore në mënyrë efikase, duke i informuar fermerët për këto praktika dhe duke i rritur njohuritë e palëve të interesit⁴³. Për Kosovën, pasi të arrihet akreditimi, programi IPARD III, paraqet një mundësi premtuese, për financim alternativ në sektorin e bujqësisë. Ky program mund të ofrojë financim për fermerët dhe agro bizneset, për të investuar në infrastrukturë, pajisje dhe praktika të qëndrueshme, duke i mundësuar atyre të rrisin produktivitetin dhe të përmbushin standardet e BE-së.

7. Mundësitë/rekomandimet për të mbështetur tranzicionin e qëndrueshëm dhe të gjelbër

Sektori bujqësor i Kosovës ndodhet në një pikë kritike teksa kërkon të kalojë drejt praktikave më të qëndrueshme, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe objektivat globale mjedisore. Megjithë përparimin e dukshëm, sfidat mbeten të mëdha, duke përfshirë pronësinë e fragmentuar të tokës, infrastrukturën e vjetëruar, qasjen e kufizuar në financa dhe mungesën e ndërgjegjësimit midis fermerëve për përfitimet e qëndrueshmërisë. Për të adresuar këto çështje, nevojitet një qasje gjithëpërfshirëse, duke përfshirë përmirësimin e trajnimit teknik, rritjen e ndërgjegjësimit, përmirësimin e qasjes në treg dhe harmonizimin më të mirë të politikave me direktivat e BE-së. Duke shfrytëzuar bashkëpunimin ndërkombëtar, mekanizmat financiarë dhe teknologjitë inovative, Kosova mund të ndërtojë një sektor bujqësor më të qëndrueshëm, konkurrues dhe të qëndrueshëm mjedisor që jo vetëm përmirëson mirëqenien e fermerëve të saj, por gjithashtu kontribuon në objektivat më të gjera ekonomike dhe mjedisore të vendit.

Më poshtë janë disa rekomandime dhe sugjerime për mbështetjen e tranzicionit drejt bujqësisë së qëndrueshme në Kosovë:

Përmirësimi i trajnimit teknik dhe mbështetjes për fermerët

Programe të vazhdueshme trajnimi:

- **Trajnimi i personalizuar:** Zhvillimi i programeve të trajnimit të dizajnuara posaçërisht për lloje të ndryshme të operacioneve bujqësore (p.sh., të madhësisë së vogël kundrejt atyre të mëdha, organike kundrejt konvencionaleve). Këto duhet të përfshijnë një gamë të gjerë temash, duke përfshirë menaxhimin e shëndetit të tokës, menaxhimin e integruar të dëmtuesve (MID), ruajtjen e ujit, përdorimin e energjisë së rinovueshme dhe strategjitë për rritjen e qëndrueshmërisë ndaj klimës.
- **Punëtori praktike:** Organizimi i punëtorive praktike dhe demonstrimeve në terren për t'u treguar fermerëve si të zbatojnë praktikatat e qëndrueshme. Këto mund të përfshijnë demonstrime për mënyrën e krijimit dhe menaxhimit të sistemeve të kompostimit organik, instalimin dhe mirëmbajtjen e paneleve diellore, ose optimizimin e sistemeve të ujitjes pike-pikë.

⁴³ <https://www.greenpolicyplatform.org/sites/default/files/downloads/best-practices/Greening%20Agriculture%20in%20the%20Western%20Balkans.pdf>

Shërbime këshillimore:

- **Qendra këshillimore lokale:** Themelimi i qendrave këshillimore brenda komunave, ku fermerët mund të kenë qasje në këshilla nga ekspertët për praktikën e qëndrueshme bujqësore. Këto qendra mund të ofrojnë përditësime të rregullta për teknologjitë e reja, tendencat e tregut dhe praktikën më të mira në qëndrueshmëri.
- **Njësi këshillimore mobile:** Krijimi i njësive këshillimore mobile që mund të vizitojnë fermerët për të ofruar këshilla të personalizuar dhe mbështetje teknike, duke ndihmuar fermerët të zgjidhin çështje specifike të lidhura me praktikën e qëndrueshme.

Rritja e ndërgjegjësimit dhe dijeve

Fushata ndërgjegjësimi:

- **Përfitimet mjedisore dhe ekonomike:** Nisja e fushatave që theksojnë përfitimet e dyfishta të praktikave të qëndrueshme: përmirësimin e mjedisit dhe rritjen e fitimeve nga fermerët. Përdorimi i historive të suksesit nga Kosova ose rajone të ngjashme për të treguar se si praktikën e qëndrueshme mund të çojnë në prodhimtari më të lartë, cilësi më të mirë të produkteve dhe qasje të zgjeruar në treg.
- **Rrjetet sociale dhe platformat digjitale:** Shfrytëzimi i mediave sociale, faqet e internetit dhe aplikacionet mobile për të arritur një audiencë më të gjerë, duke përfshirë fermerët më të rinj. Krijimi i përmbajtjeve tërheqëse, si video, info-grafikë dhe mjete interaktive që shpjegojnë praktikën e qëndrueshme bujqësore.

Shoqatat e fermerëve:

- **Ngritja e kapaciteteve:** Ofrimi i trajnimeve dhe burimeve për të forcuar shoqatat e fermerëve, duke i mundësuar atyre të luajnë një rol më aktiv në promovimin e praktikave të qëndrueshme. Kjo mund të përfshijë trajnime në udhëheqësi, komunikim dhe avokim, si dhe aftësi teknike në bujqësi të qëndrueshme. Kjo gjithashtu do të ishte relevante për profesionistët e rinj, qoftë duke përfshirë bujqësinë e qëndrueshme në kurrikulat aktuale të universiteteve që kanë Fakultetin e Bujqësisë, ose duke zhvilluar aftësitë e tyre në këtë temë përmes programeve të personalizuar trajnimi.
- **Rrjete të mësimit nga kolegët:** Inkurajimi i formimit të rrjeteve të mësimit nga kolegët brenda këtyre shoqatave, ku fermerët mund të ndajnë përvoja, sfida dhe zgjidhje të lidhura me bujqësinë e qëndrueshme.

Përmirësimi i qasjes në financim dhe stimujt ekonomikë

Skema grantesh të personalizuar:

- **Lidhja e granteve me metrikat e qëndrueshmërisë:** Modifikimi i skemave ekzistuese të granteve për të shpërblyer praktikën që rrisin qëndrueshmërinë, si reduktimi i përdorimit të kimikateve, ruajtja e ujit dhe mbrojtja e biodiversitetit. Sigurimi që këto grante të jenë të kushtëzuara me rezultate të matshme, si reduktimi i përdorimit të pesticideve ose përmirësimi i shëndetit të tokës.
- **Subvencione të targetuara:** Prezantimi i subvencioneve për praktika të caktuara të qëndrueshme, siç janë certifikimi organik, instalimi i sistemeve të energjisë së rinovueshme, ose adoptimi i teknologjive të bujqësisë precize. Këto subvencione duhet të mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të kostove fillestare për të bërë këto praktika më të qasshme.

Qasja në kreditim:

- **Zhvillimi i produkteve të kredisë së gjelbër:** Bashkëpunimi me institucionet financiare për të krijuar produkte kredie specifike për investime në bujqësi të qëndrueshme, si blerja e farave organike, sistemeve të energjisë së rinovueshme, ose teknologjive të ujitjes me kursim të ujit. Këto kredi mund të kenë norma më të ulëta interesi ose periudha më të gjata të kthimit për t'i bërë më tërheqëse. Për më tepër, financimi alternativ përmes bankave, veçanërisht kreditë e gjelbra, mund të përfshihet si një burim plotësues i financimit për grantet e MBPZHR-së. Kjo qasje do të lehtësonte një tranzicion të ngadaltë nga financimi i drejtpërdrejtë qeveritar drejt mekanizmave komercialë financiarë, duke promovuar investime dhe inovacione afatgjata në sektorin bujqësor.
- **Skema të garancisë së kredisë:** Zgjerimi i skemave ekzistuese të garancisë së kredisë për të reduktuar rrezikun e perceptuar nga bankat në dhënien e kredive për fermerët që po kalojnë në praktika të qëndrueshme. Kjo mund të kombinohet me mbështetje teknike për të siguruar që këto investime të jenë të suksesshme.

Fuqizimi i qasjes në treg për produktet e qëndrueshme

Zhvillime të diktuar nga tregu:

- **Certifikimi dhe brendimi:** Mbështetja e fermerëve në marrjen e certifikatave organike ose të qëndrueshmërisë, të cilat mund të hapin qasje në tregje premium, veçanërisht në BE. Krijimi i një marke kombëtare për produktet e qëndrueshme dhe organike të Kosovës për të përmirësuar dukshmërinë dhe tregtueshmërinë.
- **Panaire tregtare dhe promovimi i eksportit:** Organizimi i pjesëmarrjes në panaire tregtare ndërkombëtare dhe ngjarje për promovimin e eksportit për të prezantuar produktet bujqësore të qëndrueshme të Kosovës. Kjo mund t'i ndihmojë fermerët të lidhen me blerës që janë të gatshëm të paguajnë një çmim më të lartë për produkte të certifikuar dhe të qëndrueshme.

Mbështetja e zinxhirëve të vlerës:

- **Zhvillimi i infrastrukturës:** Investimi në infrastrukturë që mbështet të gjithë zinxhirin e vlerës, nga prodhimi te përpunimi deri te tregu. Kjo mund të përfshijë krijimin e impianteve lokale të përpunimit, magazinave frigoriferike dhe rrjeteve të transportit që janë të qasshme për fermerët e vegjël.

Përmirësimi i kornizave politike dhe rregullatore

Përputhja me standardet e BE-së:

- **Harmonizimi i politikave:** Përshpejtimi i përpjekjeve për të përafuar politikat bujqësore të Kosovës me standardet e BE-së, duke u fokusuar në fusha si rregullimi i pesticideve, menaxhimi i ujit dhe bujqësia organike. Kjo mund të përfshijë rishikimin e ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese për të reflektuar direktivat e BE-së, si dhe zbatimin e politikave të reja që promovojnë praktika të qëndrueshme.
- **Mbështetje për përputhshmëri:** Ofrimi i mbështetjes për fermerët dhe bizneset agro-bujqësore për t'u përshtatur me këto kërkesa të reja rregullatore, duke përfshirë subvencione ose asistencë teknike për t'i ndihmuar ata të kalojnë në përputhshmëri me këto kërkesa.

Stimulimi i praktikave të qëndrueshme:

- **Stimuj rregullator:** Prezantimi i rregulloreve që kërkojnë ose inkurajojnë praktikat e qëndrueshme, si detyrimi për rotacionin e kulturave ose ofrimi i lehtësimeve tatimore për fermat që përdorin energji të rinovueshme. Këto rregullore duhet të mbështeten nga mekanizma të fortë të zbatimit për të siguruar përputhshmërinë.
- **Vlerësimet e ndikimit mjedisor:** Bërja e vlerësimeve të ndikimit mjedisor të detyrueshme për projektet e mëdha bujqësore, duke u fokusuar në metrika të qëndrueshmërisë si efikasiteti i përdorimit të ujit, ndikimi në biodiversitet dhe gjurmët e karbonit.

Promovimi i kërkimeve dhe inovacionit

Mbështetje për kërkime:

- **Grante për kërkime:** Ofrimi i granteve për universitetet dhe institucionet kërkimore për të studiuar praktikat e qëndrueshme bujqësore dhe për të zhvilluar teknologji të reja që mund të zbatohen në kontekstin unik mjedisor dhe ekonomik të Kosovës.
- **Pilot projekte:** Financimi i projekteve pilot që testojnë teknologji ose praktika të reja të bujqësisë së qëndrueshme në kushte reale, me qëllim të zgjerimit të nismave të suksesshme.
- **Edukimi:** Rritja e përfshirjes së bujqësisë së qëndrueshme në kurrikulat e shkollave të mesme dhe universiteteve për të rritur ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e saj.
- **Bashkëpunimi:** Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet aktorëve kryesorë për studime kërkimore dhe projekte inovative në bujqësinë e qëndrueshme, si dhe krijimi i grupeve kërkimore. Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet akademisë, biznesit, ministrive dhe qeverive lokale përmes projekteve inovative të fokusuara në bujqësinë e qëndrueshme.
- **Institucionet Kërkimore:** Rritja e kapacitetit të institucioneve kërkimore për të realizuar projekte bujqësore të qëndrueshme të orientuara nga tregu. Bashkëpunimi i zgjeruar ndërmjet institucioneve kërkimore vendore dhe komunitetit kërkimor ndërkombëtar.
- **Fondet:** Sigurimi i fondeve specifike për projekte kërkimore dhe inovative në bujqësinë e qëndrueshme, si dhe përfshirja e kërkuesve të rinj. Avokimi për financim të shtuar nga qeveria dhe institucionet ndërkombëtare për kërkime dhe inovacione. Adoptimi i një modeli të inovacionit të hapur është thelbësor për financimin e suksesshëm të inovacionit. Kjo qasje promovon bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe aktorëve të shumtë (sektorët biznesorë, publikë dhe akademikë), duke mundësuar financimin e inovacioneve në nivel klasteri ose sektori.

Programet e ardhshme të financimit duhet të shfrytëzojnë në mënyrë efektive modelin e inovacionit të hapur për të promovuar ndarjen e dijes dhe avancimet në praktikat e qëndrueshme bujqësore, duke siguruar që zgjidhjet inovative të jenë të bazuara në aplikime praktike dhe të sjellin përfitime për të gjithë sektorin.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes KIESA-s, ka prezantuar këtë vit tre skema të reja grantesh me vlerë 2.5 milionë euro për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Skema e granteve mbulon blerjen e makinerive për prodhim dhe përpunim, certifikimin e produkteve dhe digjitalizimin e bizneseve. Përveç kësaj,

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë planifikon të lansojë edhe tre skema të reja grantesh për të promovuar inovacionin, turizmin dhe zhvillimin e artizanatit.

- **Politika:** Përmirësimi i kuadrit ligjor për inovacionin, transferimin e dijes dhe financimin e kërkimeve shkencore në lidhje me bujqësinë e qëndrueshme. Në të ardhmen, përputhshmëria me Strategjinë Evropiane të Shkencës 2021-2026 duhet të merret parasysh në dokumentet strategjike të ndryshme që lidhen me shkencën. Zbatimi dhe monitorimi i Programit Kombëtar të Shkencës të Republikës së Kosovës 2023-2028, i cili inkurajon teknologjitë bujqësore inovative. Zbatimi dhe monitorimi i Ligjit për inovacionin shkencor dhe transferimin e dijes dhe teknologjisë.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe ministrive përkatëse që janë përgjegjëse për motivimin dhe promovimin e zhvillimit të aktiviteteve inovative. Zbatimi dhe monitorimi i Ligjit për aktivitetet kërkimore-shkencore për përmbushjen e kushteve të nevojshme dhe për sigurimin e fondeve për promovimin e kërkimeve.

Lehtësimi i investimeve në infrastrukturë dhe teknologji

Energjia e rinovueshme:

- **Energjia diellore:** Zgjerimi i instalimit të paneleve diellore me fokus në zgjidhjet jashtë rrjetit për zonat e largëta dhe për operacionet e mëdha bujqësore. Gjithashtu, sigurimi që kapaciteti i instaluar të përputhet me nivelet e konsumit të fermës, si dhe të jetë i cilësisë së lartë. Ofrimi i trajnimeve për instalimin, mirëmbajtjen dhe përfitimet ekonomike të energjisë së rinovueshme.
- **Efiçienca e energjisë:** Promovimi i masave për efiçencën e energjisë, si përmirësimi i pompave të ujitjes ose përmirësimi i izolimit në objektet e magazinimit, për të reduktuar konsumimin e energjisë dhe kostot.

Menaxhimi i ujërave:

- **Sisteme të avancuara të ujitjes:** Inkurajimi i adoptimit të sistemeve të ujitjes pike-pikë dhe teknologjive të tjera për kursimin e ujit duke ofruar subvencione, asistencë teknike dhe demonstrime të efektivitetit të tyre.
- **Grumbullimi dhe riciklimi i ujit:** Promovimi i përdorimit të sistemeve për grumbullimin e ujit të shiut dhe riciklimin e ujërave të përdorura për ujitje, veçanërisht në zonat e prekura nga mungesa e ujit. Këto sisteme mund të integrohen në dizajnet e reja të fermave ose të përshtaten në operacionet ekzistuese.

Forcimi i mbështetjes institucionale dhe qeverisjes

Ngritja e kapaciteteve:

- **Forcimi institucional:** Investimi në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve qeveritare përgjegjëse për bujqësinë, mjedisin dhe zhvillimin rural për të zbatuar dhe zbatuar politikat e bujqësisë së qëndrueshme. Kjo mund të përfshijë programe trajnimi, rritje të stafit dhe zhvillimin e mjeteve të reja për monitorim dhe vlerësim.
- Divizioni për Agro-Mjedis në organogramin e ri të MBPZHR-së mund të rifreskohet në të ardhmen si divizion për bujqësinë e qëndrueshme, i cili mund të përfshijë agro-mjedisin dhe bujqësinë organike.

- **Mekanizmat e koordinimit:** Krijimi i mekanizmave për koordinim më të mirë ndërmjet agjencive qeveritare, OJQ-ve dhe sektorit privat për të thjeshtuar mbështetjen për bujqësinë e qëndrueshme. Kjo mund të përfshijë krijimin e grupeve të punës ndër-institucionale ose forcave të posaçme të fokusuara në çështje specifike të qëndrueshmërisë.

Shfrytëzimi i bashkëpunimit dhe financimit ndërkombëtar

Partneritetet ndërkombëtare:

- **Bashkëpunimi me donatorët:** Vazhdimi i punës me donatorët ndërkombëtarë dhe organizatat zhvillimore për të siguruar financim dhe asistencë teknike për projekte të bujqësisë së qëndrueshme. Përqendrohuni në ndërtimin e partneriteteve që sjellin ekspertizë, teknologji dhe qasje të reja.
- **Pjesëmarrja në nisma rajonale:** Angazhimi më aktiv në nisma rajonale, si Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, e cila mund të ofrojë qasje në burime shtesë, shkëmbim njohurish dhe projekte bashkëpunuese.

Qasja në mekanizmat e financimit:

- **Bankat zhvillimore multilaterale :** Kërkimi i financimit nga bankat zhvillimore multilaterale, si Banka Botërore dhe BERZH, për projekte në shkallë të gjerë që mund të sjellin përmirësime të rëndësishme në qëndrueshmëri, si përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes ose zhvillimi i kapaciteteve të energjisë së rinovueshme.
- **Financimi për klimën:** Eksplorimi i mundësive për të qasur financimin për klimën, si Fondi i Gjelbër për Klimën, për të mbështetur projekte që rrisin qëndrueshmërinë ndaj klimës në sektorin bujqësor. Këto fonde mund të përdoren për të zbatuar praktika dhe teknologji të bujqësisë inteligjente ndaj klimës.

Fushat e sugjeruara të ndërhyrjes për sektorë të veçantë

Sektori i qumështit:

- **Menaxhimi i Plehut Organik:** Investimi në objekte për ruajtjen e plehut organik dhe pajisje për shpërndarjen e tij. Ofrimi i edukimit mbi përfitimet mjedisore dhe të produktivitetit nga menaxhimi i duhur i plehut, duke përfshirë reduktimin e emetimeve të metanit dhe përmirësimin e shëndetit të tokës.
- **Kërkesat e Tregut:** Zhvillimi i tregjeve të eksportit që kërkojnë praktika të qëndrueshme në industrinë e qumështit, si standardet e larta të mirëqenies së kafshëve ose gjurmët e ulëta të karbonit, për të inkurajuar fermerët të adoptojnë këto praktika.

Perimet:

- **Shëndeti i tokës:** Promovimi i përdorimit të rotacionit të kulturave, bimëve mbuluese dhe plehrave organike për të përmirësuar shëndetin e tokës. Ofrimi i trajnimeve mbi përfitimet e ruajtjes së tokës dhe përfitimet e produktivitetit afatgjatë nga ruajtja e tokave të shëndetshme.
- **Menaxhimi i pesticideve:** Edukimi i fermerëve mbi rreziqet e përdorimit të tepërt të pesticideve dhe plehrave, duke përfshirë zhvillimin e dëmtuesve rezistentë dhe ndotjen mjedisore. Prezantimi i praktikave të menaxhimit të integruar të dëmtuesve si një alternativë.

Frutat e buta:

- **Qëndrueshmëria ndaj klimës:** Mbështetje për investimet në rrjeta anti-grusht dhe sisteme digjitale ujitjeje për të mbrojtur kulturat nga rreziqet e lidhura me klimën, si temperaturat ekstreme dhe mungesa e ujit. Ofrimi i granteve ose kredive me interesa të ulëta për të mbuluar kostot e larta fillestare të këtyre teknologjive.
- **Tranzicioni në organik:** Inkurajimi i më shumë fermerëve të kalojnë në menaxhimin e integruar të dëmtuesve dhe pastaj në prodhimin organik duke ofruar mbështetje financiare, asistencë teknike dhe qasje në tregjet që kërkojnë produkte organike.

Bimët mjekësore dhe aromatike:

- **Aplikimet në grup për grante:** Lehtësimi i aplikimeve në grup për grante për të lejuar fermerët e vegjël të investojnë së bashku në teknologji të reja, si pajisje të specializuara për prodhimin organik ose objekte të përbashkëta për përpunim.
- **Ndërgjegjësimi i konsumatorëve:** Nisja e fushatave për të rritur ndërgjegjësimin mbi përfitimet e bimëve mjekësore dhe aromatike organike midis konsumatorëve lokalë, duke ndihmuar në ndërtimin e një tregu të brendshëm përveç mundësive të eksportit.

8. Shtojca 1 – Lista e palëve të interesit

Intervistat me informatorë kryesorë (IIK)	Pjesëmarrësit në diskutimet e grupeve të fokusuara (DGF)
MBPZHR	Shoqata e Prodhuesve të Qumështit të Kosovës
International Finance Corporation (IFC)	Shoqata e Përpunuesve të Qumështit të Kosovës
Balkan Green Foundation	Organica
Fondi i Kosovës për Garanci Kreditore	Pepeko
Tregtarët e inputeve (Agronomi, Agromarket, Agrohelp, Agroeko)	Mjedra e Kosovës
Caritas	AgroDev
CNVP	Qumështorja Eurolona
Care International	Qumështorja Aldi
	Ferma e qumështit Rudina
	Agro Celina
	Bliff & Agroproduct Syne
	Eurofruti

9. Shtojca 2 – Informacion mbi rregulloret

Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural Nr. 08/L-072 në nenin përkatës përmend se zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë duhet të mbështetet në veçanti në përdorimin ekologjik të burimeve, prodhimin bujqësor të integruar, bujqësinë organike, zbatimin e projekteve të kërkimit dhe zhvillimit të aplikuar, bashkëpunimin me institucionet shkencore dhe në krijimin e shërbimeve këshilluese.

Ligji për Bujqësinë Organike Nr. 04/L-085, i cili është hartuar në përgjigje të Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 834/2007 mbi prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike, është pjesë e kuadrit ligjor aktual të Kosovës. Qëllimi kryesor i këtij ligji është të sigurojë bazën për zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit organik, duke garantuar funksionimin efektiv të tregut, konkurrencë të drejtë, besimin e konsumatorëve dhe mbrojtjen e interesave të tyre.

Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L-26 përcakton përdorimin, mbrojtjen, rregullimin dhe qiradhënien e tokës bujqësore me qëllim të ruajtjes së përhershme dhe mbrojtjes së potencialit bujqësor, bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Për më tepër, MBPZHR ka përgatitur legjislacion dytësor për bujqësinë organike, të mbështetur nga projekti KosAgri dhe ekspertët e TAIEX-it. Bazuar në Ligjin aktual, janë përgatitur tetë Udhëzime Administrative.

Është gjithashtu e rëndësishme të përmendet se MBPZHR ka miratuar Planin Kombëtar të Veprimit për Bujqësinë Organike për vitet 2023–2026, i cili është thelbësor për bujqësinë organike. Bujqësia organike konsiderohet nga shumica e individëve me të cilët kemi folur nga sektorë të ndryshëm si rruga drejt bujqësisë së qëndrueshme.